

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 315 (I RISHIKUAR)

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2013 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Qëllimi i këtij SNA-je	1
Hyrja në fuqi	2
	3
Objektivi	
Përkufizimet	4
Kërkesat	
Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Aktivitetet Përkatëse	5-10
Njohja e Kërkuar e Entitetit dhe Mjedisit të tij, Përfshirë Kontrollin e Brendshëm të Entitetit	11-24
Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale	25-31
Dokumentimi	32
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Aktivitetet Përkatëse	A1-A24
Njohja e Kërkuar e Entitetit dhe Mjedisit të tij, Përfshirë Kontrollin e Brendshëm të Entitetit	A25-A121
Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale	A122-A152
Dokumentimi	A153-A156

Shtojcë 1: Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm

Shtojcë 2: Kushtet dhe Ngjarjet që Mund të Tregojnë për Rreziqe të Anomalisë Materiale

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 315, “Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.”

Hyrje

Objekti Qëllimi i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare, nëpërmjet njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit.

Hyrja në Fuqi

2. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2013 ose pas kësaj date.

Objektivi

3. Objektivi i audituesit është që të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale, për shkak të mashtrimit ose gabimit, në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivelet e pohimit, nëpërmjet njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit, duke siguruar në këtë mënyrë një bazë për projektimin dhe zbatimin e procedurave të nevojshme të auditimit si reagim ndaj rreziqeve të vlerësuara të anomalisë materiale.

Përkufizimet

4. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë kuptimet që ju janë dhënë në vijim:
 - (a) Pohimet –Paraqitjet që bëhen nga drejtimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, që janë të trupëzuara në pasqyrat financiare, të cilat përdoren nga audituesi për të shqyrtuar llojet e ndryshme të anomalive të mundshme që mund të ndodhin.
 - (b) Rreziku i Biznesit–Një rrezik që rezulton nga kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet apo mosveprimet e konsiderueshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e entitetit për të arritur objektivat e tij dhe për të ekzekutuar strategjitë e tij, ose nga përcaktimi i papërshtatshëm i objektiveve dhe strategjive.
 - (c) Kontrolli i Brendshëm–Procesi që dizajnohet, zbatohet dhe vihet në funksion nga organet e qeverisjes, drejtimi dhe personeli tjetër për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e objektiveve të entitetit lidhur me besueshmërinë e raportimit financiar, efektivitetin dhe eficientësinë e operacioneve dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Termi “kontroll i brendshëm” i referohet çdo aspekti të një ose më shumë komponentëve të kontrollit të brendshëm.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- (d) Procedurat e vlerësimit të rrezikut –Procedurat e auditimit që kryhen për të kuptuar dhe njohur veprimtarinë e entitetit dhe të mjedisit të tij, përfshirë kontrollet e tij të brendshme, me qëllim që të identifikohen dhe vlerësohen rreziqet e anomalive materiale, për shkak të gabimit ose mashtrimit, në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivelet e pohimit.
- (e) Rrezik i rëndësishëm –Një rrezik i anomalisë materiale i identifikuar dhe vlerësuar, i cili sipas gjykimit të audituesit kërkon konsideratë auditimi të posaçme.

Kërkesat

Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Aktivitetet Përkatëse

- 5. Audituesi duhet të kryejë procedura të vlerësimit të rrezikut për të siguruar një bazë për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivelet e pohimit. Megjithatë, procedurat e vlerësimit të rrezikut, nuk sigurojnë në vetvete evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme mbi të cilën të bazohet opinioni i audituesit. (Ref: Para.A1–A5)
- 6. Procedurat e vlerësimit të rrezikut përfshijnë sa më poshtë:
 - (a) Kërkimi i informacionit nga drejtuesit, individët e duhur brenda funksionit të auditimit të brendshëm (nëse ky funksion ekziston) dhe persona të tjerë brenda entitetit, të cilët sipas gjykimit të audituesit mund të kenë informacion i cili ka të ngjarë që të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit ose gabimit. (Ref:Para.A6-A13)
 - (b) Procedurat analitike.(Ref:Para. A14-A17)
 - (c) Vëzhgimin dhe inspektimin.(Ref: Para.A18)
- 7. Audituesi duhet të vlerësojë nëse informacioni i marrë nga procesi i pranimit ose vazhdimit të marrëdhënieve të tij me klientin është i përshtatshëm për identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale.
- 8. Në rastet kur ortaku i angazhimit ka kryer angazhime të tjera për entitetin, ortaku i angazhimit duhet të vlerësojë nëse informacioni i marrë është i përshtatshëm për identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale.
- 9. Në rastet kur audituesi synon të përdorë informacione që ka marrë nga eksperiencia të mëparshme të tij me entitetin dhe nga procedura auditimi të kryera në auditime të mëparshme, audituesi duhet të ketë parasysh faktin nëse në këtë entitet kanë ndodhur ndryshime, të cilat mund të ndikojnë në përshtatshmërinë e këtyre informacioneve për auditimin aktual. (Ref: Para.A19–A20)
- 10. Ortaku i angazhimit dhe anëtarë të tjerë të rëndësishëm të grupit të angazhimit duhet të

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

diskutojnë në lidhje me ndjeshmërinë që kanë pasqyrat financiare ndaj anomalive materiale, dhe aplikimin e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar për faktet dhe për rrethanat e entitetit. Ortaku i anagazhimit duhet të përcaktojë se cilat çështje i duhen komunikuar anëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit të cilët nuk janë përfshirë në diskutim. (Ref: Para.A21–A24)

Njohja e Kërkuar e Entitetit dhe Mjedisit të tij, Përfshirë Kontrollin e Brendshëm të Entitetit

Entiteti dhe Mjedisi i tij

11. Audituesi duhet të njohjë sa më poshtë:

- (a) Sektorin e ekonomisë ku entiteti zhvillon aktivitetin e tij, kuadrin rregullator dhe faktorët e tjerë të jashtëm, përfshirë edhe kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. (Ref: Para.A25–A30)
- (b) Natyrën e entitetit, përfshirë:
 - (i) operacionet e tij;
 - (ii) strukturat e tij të drejtimit dhe qeverisjes;
 - (iii) llojet e investimeve që entiteti ka bërë ose planifikon të bëjë, përfshirë investimet në entitetet për qëllime të veçanta; dhe
 - (iv) mënyrën sesi është strukturuar dhe financohet entiteti, për të bërë të mundur që audituesi të kuptojë klasat e transaksioneve, tepricat e llogarisë dhe informacionet që pritet të jepen në pasqyrat financiare. (Ref:Para. A31–A35)
- (c) Politikat kontabël që entiteti ka zgjedhur dhe zbatuar, së bashku me arsyet për ndryshime në to. Audituesi duhet të vlerësojë nëse politikat kontabël të entitetit janë në përshatje me veprimtarinë e entitetit dhe në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe me politikat kontabël që përdoren në sektorin përkatës të ekonomisë. (Ref: Para. A36)
- (d) Objektivat dhe strategjitë e entitetit, dhe rreziqet përkatëse të veprimtarisë që mund të çojnë në rreziqe të anomalisë materiale. (Ref:Para.A37–A43)
- (e) Matjen dhe rishikimin e performancës financiare të entitetit. (Ref:Para. A44–A49)

Kontrolli i Brendshëm i Entitetit

12. Audituesi duhet të njohë kontrollin e brendshëm që është i rëndësishëm për auditimin.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

Megjithëse pjesa më e madhe e kontrolleve të rëndësishme për auditimin ka të ngjarë të jenë të lidhur me raportimin financiar, jo të gjithë kontrollet që janë të lidhur me raportimin financiar janë të rëndësishme për auditimin. I përket gjykimit profesional të audituesit që të vlerësojë nëse një kontroll, më vete ose i kombinuar me të tjerë, është i rëndësishëm për auditimin. (Ref:Para.A50–A73)

Natyra dhe Shtrirja e Njohjes së Kontrolleve të Përshtatshme

13. Gjatë njohjes së kontrolleve që kanë të bëjnë me auditimin, audituesi duhet të vlerësojë mënyrën sesi janë ndërtuar këto kontrolle dhe të shohë nëse ato kanë gjetur zbatim, duke kryer procedura që plotësojnë informacionet e marra nga personeli i entitetit. (Ref: Para.A74–A76)

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm

Mjedisi i Kontrollit

14. Audituesi duhet të njohë mjedisin e kontrollit. Si pjesë e kësaj njohjeje, audituesi duhet vlerësojë nëse:
- (a) Drejtimi, nën mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me qeverisjen, ka krijuar dhe ruajtur një kulturë ndershmërie dhe sjelljeje etike; dhe
 - (b) Anët e forta në elementët e mjedisit të kontrollit së bashku krijojnë një bazë të përshtatshme për elementët e tjerë përbërës të kontrollit të brendshëm, dhe nëse këto elementë të tjerë nuk janë dobësuar nga mangësitë në mjedisin e kontrollit. (Ref: Para.A77–A87)

Procesi i Vlerësimit të Rrezikut të Entitetit

15. Audituesi duhet të vlerësojë nëse entiteti përdor një proces për të:
- (a) Identifikuar rreziqet e veprimtarisë, që kanë të bëjnë me arritjen e objektivave të raportimit financiar;
 - (b) Çmuar rëndësinë e rreziqeve;
 - (c) Vlerësuar mundësitë e ndodhjes së tyre; dhe
 - (d) Vendosur lidhur me veprimet që duhen bërë për trajtimin e këtyre rreziqeve; (Ref:Para.A88)
16. Në qoftë se entiteti ka në zbatim një proces të tillë (referuar tani e në vijim si “procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit”), audituesi duhet të arrijë ta njohë këtë proces dhe rezultatet që e shoqërojnë atë. Nëse audituesi identifikon rreziqe të anomalisë materiale

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

që drejtimi nuk ka arritur t'i zbulojë, ai duhet të shqyrtojë faktin nëse ka ndonjë rrezik të fshehtë që audituesi priste që të ishte zbuluar nga procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit. Nëse konstatohet një rrezik i tillë, audituesi duhet të vlerësojë shkaqet pse nuk është arritur të identifikohet nga procesi, si edhe vetë procesin nëse ai është i përshtatshëm në rrethanat përkatëse ose të arrijë në konkluzionin që ka një mangësi të rëndësishme në procesin e vlerësimit të rrezikut të entitetit.

17. Në rastet kur entiteti nuk ka përcaktuar një proces të tillë ose ka një proces i cili zbatohet atëherë kur është e nevojshme, audituesi duhet të diskutojë me drejtimin lidhur me faktin nëse janë identifikuar rreziqet e veprimtarisë që kanë të bëjnë me arritjen e objektivave të raportimit financiar dhe sesi janë trajtuar këto rreziqe. Audituesi duhet të vlerësojë gjithashtu nëse mungesa e një procesi të dokumentuar për vlerësimin e rrezikut është e përshtatshme për rrethanat, ose të arrijë në konkluzionin që një mungesë e tillë përbën një mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm. (Ref:Para.A89)

Sistemi i Informacionit, përfshirë Proceset Përkatëse të Veprimtarisë, që lidhen me Raportimin Financiar dhe Komunikimin

18. Audituesi duhet të njohë sistemin e informacionit, së bashku me proceset përkatëse të veprimtarisë, që kanë të bëjnë me raportimin financiar, ku përfshihen fushat e mëposhtme: (Ref:Para.A90-A92 dhe A95-A96)

- (a) Klasat e transaksioneve që marrin pjesë në veprimtarinë e entitetit, të cilat janë të rëndësishme për pasqyrat financiare;
- (b) Procedurat, qoftë për sistemet e teknologjisë dhe informacionit (TI) ashtu edhe për ato manuale, sipas të cilave transaksionet inicohen, regjistrohen, përpunohen, korrigjohen sipas rastit, transferohen në librin e madh dhe raportohen në pasqyrat financiare;
- (c) Regjistrimet përkatëse kontabël, informacioni mbështetës dhe llogaritë specifike në pasqyrat financiare, që janë përdorur për të iniciuar, regjistruar, përpunuar dhe raportuar transaksionet; kjo përfshin edhe korrigjimin e informacionit të pasaktë dhe se si informacioni është transferuar në librin e madh. Regjistrimet mund të jenë në formë elektronike ose manuale;
- (d) Mënyra me të cilën sistemi i informacionit, përveç klasave të transaksioneve, evidenton ngjarjet dhe kushtet, që janë të rëndësishme për pasqyrat financiare;
- (e) Procesit i raportimit financiar i përdorur për të përgatitur pasqyrat financiare, duke përfshirë çmuarjet kontabël të rëndësishme dhe informacionet që duhet të jepen;dhe
- (f) Kontrollat që monitorojnë artikujt kontabël, duke përfshirë artikujt kontabël jo standard të përdorur për të regjistruar transaksionet e pazakonta, jo periodike ose

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

regjistrimet rregulluese. (Ref:Para.A93–A94)

Njohja e sistemit të informacionit të rëndësishëm për raportimin financiar duhet të përfshijë aspektet përkatëse të këtij sistemi në lidhje me informacionin e dhënë në pasqyrat financiare, i cili është siguruar nga brenda ose jashtë librit të madh dhe librave ndihmës.

19. Audituesi duhet të njohë mënyrën se si entiteti i komunikon rolet dhe përgjegjësitë e raportimit financiar dhe çështjet e tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me raportimin financiar, përfshirë: (Ref: Para.A97–A98)

(a) Komunikimet ndërmjet drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen; dhe

(b) Komunikimet e jashtme siç janë ato me autoritetet rregullatore.

Aktivitetet e kontrollit të përshtatshme për qëllime të auditimit.

20. Audituesi duhet të njohë aktivitetet e kontrollit të përshtatshme për qëllime të auditimit, duke qënë se janë këto aktivitete që e ndihmojnë atë për të kuptuar vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në nivel të pohimeve dhe për të projektuar procedura të mëtejshme auditimi si reagim ndaj vlerësimeve për rreziqet. Audituesit nuk i kërkohet që të kuptojë të gjitha aktivitetet e kontrollit që lidhen me secilën klasë të rëndësishme të transaksioneve, të tepricave të llogarive dhe të informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare, ose në çdo pohim që u përket atyre. (Ref: Para. A99–A106)

21. Për të kuptuar aktivitetet e kontrollit të entitetit, audituesi duhet të njohë mënyrën se si reason entiteti ndaj rreziqeve që burojnë nga sistemi i TI. (Ref: Para. A107–A109)

Monitorimi i Kontrolleve

22. Audituesi duhet të njohë tipet kryesore të aktiviteteve që entiteti përdor për të vëzhguar kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar, përfshirë aktivitetet e kontrollit të rëndësishme për auditimin dhe mënyrën se si entiteti ndërmer veprimet korrigjuese ndaj mangësive në kontrollet e tij.(Ref:Para.A110–A112)

23. Në rastet kur entiteti ka të përfshirë në strukturën e tij funksionin e auditit të brendshëm¹, audituesi duhet të njohë natyrën e përgjegjësive të funksionit të auditimit të brendshëm, statusin e tij organizativ, dhe aktivitetet që kryen, ose që do të kryejë. (Ref:Para. A113-A120)

24. Audituesi duhet të njohë burimet e informacionit që janë përdorur në aktivitetet e

¹SNA 610 (Rishikuar në vitin 2013), *Përdorimi i Punës së Audituesve të Brendshëm*, paragrafi 14(a), përkufizon termin “funksioni i auditimit të brendshëm” për qëllime të SNAve,

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

monitorimit të entitetit, si dhe të bazës mbi të cilën drejtuesit e vlerësojnë informacionin si të mjaftueshmërisht të besueshëm për qëllimin përkatës. (Ref:Para. A121)

Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale

25. Audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale në:

- (a) nivel të pasqyrave financiare; dhe (Ref: Para.A122–A125)
- (b) nivel pohimi për klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe për informacionet e dhëna,(Ref: Para.A126–A131)

për të siguruar një bazë për projektimin dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit.

26. Për këtë qëllim, audituesi duhet:

- (a) Të identifikojë rreziqet gjatë procesit të njohjes së entitetit dhe të mjedisit të tij, përfshirë kontrollet përkatëse që lidhen me rreziqet, dhe të shqyrtojë klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe informacionet e tjera të dhëna në pasqyrat financiare; (Ref:Para.A132–A136)
- (b) Të çmojë rreziqet e identifikuar dhe të vlerësojë nëse këto rreziqe janë të përhapura në pasqyrat financiare si një e tërë dhe potencialisht ndikojnë në shumë pohime;
- (c) Të krijojë lidhjen midis rreziqeve të identifikuar dhe asaj ç’ka mund të jetë gabim në nivel pohimi, duke marrë në konsideratë kontrollet e përshtatshme që audituesi synon të testojë; dhe (Ref:Para.A137–A139)
- (d) Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së anomalive, përfshirë mundësinë e anomalive të shumëfishta,dhe nëse këto anomali të mundshmejanë të një madhësie të tillë që mund të çojnë në anomali materiale. (Ref:Para. A140)

Rreziqet që Kërkojnë Konsiderata Auditimi të Veçanta

27. Si pjesë e procesit të vlerësimit të rrezikut siç përshkruhet në paragrafin 25, audituesi duhet të përcaktojë, nëse ndonjë nga rreziqet e identifikuar është, sipas gjykimit të tij, rrezik i rëndësishëm. Në dhënien e këtij gjykimi, audituesi duhet të përjashtojë efektet e kontrolleve që zbatohen për këtë rrezik.

28. Për të gjykuar se cilët rreziqe janë rreziqe të rëndësishme, audituesi duhet të marrë në konsideratë të paktën aspektet e mëposhtme:

- (a) Faktin nëse rreziku shkaktohet nga mashtrimi;

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- (b) Faktin nëse rreziku është i lidhur me zhvillimet e fundit të rëndësishme ekonomike, në fushën e kontabilitetit, apo zhvillime të tjera dhe për këtë arsye ky rrezik kërkon një vëmendje të veçantë;
- (c) Kompleksitetin e transaksioneve;
- (d) Faktin nëse rreziku ka të bëjë me transaksione të rëndësishme të kryera me palët e lidhura;
- (e) Shkallën e subjektivitetit në matjen e informacionit financiar që lidhet me rrezikun, veçanërisht ato matje që përfshijnë një interval të gjerë të pasigurisë së matjes; dhe
- (f) Faktin nëse rreziku përfshin transaksione të rëndësishme, që janë jashtë aktivitetit normal të veprimtarisë së entitetit, ose thënë ndryshe, janë të jashtëzakonshme. (Ref:Para. A141–A145)

29. Në rastet kur audituesi ka arritur në konkluzionin që ekziston një rrezik i rëndësishëm, audituesi duhet të njohë strukturën e kontrolleve të entitetit, përfshirë aktivitetet e kontrollit që zbatohen për këtë rrezik. (Ref: Para.A146–A148)

Rreziqet për të cilat, Kryerja Vetëm e Procedurave Thelbësore Nuk Siguron Evidencën e Nevojshme të Auditimit

30. Në lidhje me disa lloje rreziqesh, audituesi mund të gjykojë që nuk është e mundur ose praktike të sigurojë evidencën e përshtatshme të auditimit vetëm me kryerjen e procedurave thelbësore. Këto rreziqe mund të lindin nga regjistrimi i pasaktë ose jo i plotë i klasave të transaksioneve ose tepricave të llogarive të rëndësishme por me natyrë rutinë, karakteristikat e të cilave shpesh lejojnë kryerjen e proceseve mjaft të automatizuara me pak apo aspak ndërhyrje manuale. Në këto raste, kontrollat që zbaton entiteti për monitorimin e rreziqeve të tilla janë të rëndësishme për audituesin, dhe për rrjedhojë ai duhet të ketë një njohje të mirë të tyre. (Ref: Para.A149-A151)

Rishikimi i Vlerësimit të Rrezikut

31. Vlerësimi i audituesit për rreziqet e anomalisë materiale në nivel pohimi mund të ndryshojë gjatë kryerjes së auditimit, pasi audituesi të ketë siguruar evidencë auditimi shtesë. Në rrethanat kur audituesi e siguron evidencën e auditimit nga kryerja e procedurave të auditimit të mëtejshme, ose nga marrja e një informacioni të ri, dhe në të dy rastet kjo evidencë është në kontradiktë me evidencën e auditimit mbi të cilën audituesi e ka bazuar fillimisht vlerësimin, ai rishikon vlerësimin e bërë për rrezikun dhe, në përputhje me këtë rishikim, modifikon procedurat e mëtejshme të planifikuara të auditimit. (Ref:Para.A152)

Dokumentimi

32. Audituesi duhet të përfshijë në dokumentimin e auditimit²:

- (a) Diskutimet e bëra me anëtarët e grupit të angazhimit siç kërkohet nga paragrafi 10, dhe vendimet më të rëndësishme të arritura;
- (b) Elementët kryesorë të njohjes dhe të kuptimit të marrë për çdo aspekt të entitetit dhe të mjedisit të tij të specifikuar në paragrafin 11 dhe për çdo komponent të kontrollit të brendshëm të specifikuar në paragrafët 14-24; burimet e informacionit nga është siguruar kjo njohje; dhe procedurat që janë kryer për vlerësimin e rrezikut;
- (c) Rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara të anomalisë materiale në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivel pohimi siç kërkohet nga paragrafi 25; dhe
- (d) Rreziqet e indentifikuara dhe kontrollet përkatëse të lidhura me to, të cilat audituesi ka arritur t'i njohë si rrjedhojë e kërkesave të paragrafëve 27-30. (Ref: Para.A153–A156)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Aktivitetet Përkatëse (Ref: Para. 5)

A1. Njohja e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë edhe kontrollin e brendshëm të entitetit (referuar tani e në vijim si “njohja e entitetit”), është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i mbledhjes, i përditësimit dhe i analizës që ndodh gjatë gjithë auditimit. Njohja e entitetit përbën një kuadër referimi që i jep mundësi audituesit të planifikojë auditimin dhe të ushtrojë gjykimin e tij profesional, si për shembull, në rastet kur audituesi merret me aspektet e mëposhtme:

- Vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare;
- Përcaktimin e materialitetit në përputhje me SNA 320³;
- Kujdesin e treguar në zgjedhjen dhe në zbatimin e duhur të politikave kontabël si dhe në mjaftueshmërinë e dhënies së informacioneve në pasqyrat financiare;
- Identifikimin e zonave ku ka nevojë të bëhet një auditim i veçantë, për shembull, transaksionet me palët e lidhura, vlerësimi i drejtimit lidhur me

²SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët 8–11, dhe A6.

³SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e Auditimit*.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

vijimësinë e entitetit, ose shqyrtimi i qëllimit të transaksioneve të biznesit;

- Bërja e parashikimeve me qëllim përdorimin e tyre kur kryhen procedurat analitike;
- Reagimet ndaj vlerësimit të rreziqeve të anomalisë materiale, përfshirë, dizenjimin dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit për të siguruar evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi; dhe
- Vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës së auditimit të siguruar, siç është përshtatshmëria e hipotezave ashtu edhe e deklarimeve të drejtimit të bëra me gojë dhe me shkrim.

- A2. Informacioni i përftuar nga kryerja e procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet përkatëse mund të përdoret nga audituesi si evidencë auditimi për të mbështetur vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale. Përveç kësaj, gjatë kryerjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut, audituesi mund të sigurojë evidencë auditimi për klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive, ose informacionet e dhëna, dhe pohimet përkatëse, si dhe për efektshmërinë e kontrolleve, edhe pse këto procedura auditimi nuk janë planifikuar në mënyrë specifike si procedura thelbësore apo teste kontrolli. Gjithashtu, audituesi mund të parapëlqejë të kryejë procedurat thelbësore ose testet e kontrollit njëkohësisht me procedurat e vlerësimit të rrezikut, kur ai mendon se kjo është efiçente.
- A3. Audituesi përdor gjykimin profesional për të përcaktuar shkallën e njohjes së kërkuar. Preokupimi kryesor i audituesit është fakti nëse njohja e arritur është e mjaftueshme për të përmbushur objektivin e përcaktuar në këtë SNA. Nga audituesi kërkohet një njohje e përgjithshme që është më pak e thellë nga njohja që kërkohet nga ana e drejtimit për administrimin e entitetit.
- A4. Rreziqet që duhen vlerësuar përfshijnë si rreziqet për shkak të gabimit ashtu edhe ato për shkak të mashtrimit, dhe të dy këto rreziqe janë trajtuar në këtë SNA. Megjithatë, duke qënë se mashtrimi ka një rëndësi të tillë, SNA 240 përfshin kërkesa dhe udhëzime të mëtejshme në lidhje me procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet përkatëse për të siguruar informacionin e nevojshëm për identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit.⁴
- A5. Megjithëse audituesit i kërkohet që të kryejë të gjitha procedurat e vlerësimit të rrezikut të përshkruara në paragrafin 6 në funksion të arritjes së njohjes që kërkohet për entitetin (shiko paragrafët 11-24), nuk është e thënë që audituesi t'i kryejë të gjitha këto procedura për çdo aspekt të njohjes. Gjithashtu audituesi mund të kryejë edhe procedura të tjera auditimi, kur informacioni i marrë ndihmon

⁴SNA240, *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafët 13-25 .

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

në identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale. Shembuj procedurash të tilla përfshijnë:

- Shqyrtimi i informacionit të marrë nga burime të jashtme, siç janë revistat ekonomike dhe tregtare, raportet e nxjerra nga analistët, bankat apo agjencitë e tatim-taksave; ose publikimet ligjore ose financiare.
- Kërkimi i informacioneve nga këshilltarët ligjorë të jashtëm ose ekspertët e vlerësimit që i kanë shërbyer entitetit.

Kërkimi i Informacionit nga Drejtuesit, Funkzioni i Auditimit të Brendshëm dhe nga Persona të Tjerë Brenda Entitetit (Ref: Para. 6(a))

A6 Pjesën më të madhe të informacionit që sigurohet nga kërkesa për informacion, audituesi e merr nga drejtuesit dhe personat që janë përgjegjës për raportimin financiar. Informacioni gjithashtu, mund të sigurohet nga audituesi nëpërmjet kërkimit të informacioneve nga funksioni i auditimit të brendshëm, në rast se entiteti ka një funksion të tillë ose tek të tjerë brenda entitetit.

A7. Audituesi mund të sigurojë informacion gjithashtu, ose mund të marrë këndvështrim të ndryshëm lidhur me identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale, nëpërmjet kërkimit të informacioneve nga persona të tjerë brenda entitetit dhe punonjës të tjerë me nivele të ndryshme autoriteti. Për shembull:

- Kërkesat për informacione, të cilat ju drejtohen personave të ngarkuar me qeverisjen, e ndihmojnë audituesin për të njohur mjedisin në të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare. SNA 260 (i rishikuar)⁵ identifikon rëndësinë e komunikimit efektiv të dyanshëm, në ndihmë të audituesit për të marrë informacion nga ata që janë të ngarkuar me qeverisjen në këtë aspekt.
- Kërkesat për informacione nga punonjësit që kanë marrë pjesë në inicimin, përpunimin dhe regjistrimin e transaksioneve komplekse apo të pazakonta, e ndihmojnë audituesin për të vlerësuar përshtatshmërinë e zgjedhjes dhe të zbatimit të disa politikave kontabël.
- Kërkimi i informacioneve drejtpërdrejtë nga këshilltarët ligjorë mund të sigurojë informacione në lidhje me çështje të tilla si proceset gjyqësore, pajtueshmeria me ligjet dhe rregullat, njohuri për mashtrim ose dyshime për mashtrim që prekin entitetin, garancitë, detyrimet pas-shitjes, marrëveshjet me ortakë të biznesit (siç janë sipërmarrjet e përbashkëta) dhe për kuptimin e termave të kontratës.
- Kërkesat për informacione që i drejtohen personelit të shitjeve ose të

⁵SNA 260 (I rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 4(b)

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

marketingut mund të sigurojnë informacion lidhur me ndryshimet e strategjive të marketingut të entitetit, prirjet e shitjeve ose marrëveshjet kontraktuale me klientët.

- Kërkesat për informacion, që i drejtohen funksionit të manaxhimit të rrezikut (ose atyre që kryejnë këto role) mund të sigurojnë informacion rreth rreziqeve operacionale dhe rregullatore që mund të ndikojnë në raportimin financiar.
- Kërkesat për informacione drejtuar personelit të sistemit të informacionit, mund të sigurojnë informacione rreth ndryshimeve në sistem, mosfunksionimeve të sistemit apo të kontrollit ose rreziqe të tjera të lidhura me sistemin e informacionit.

A8. Duke qënë se njohja dhe kuptimi i entitetit dhe mjedisit të tij është një proces i vazhdueshëm dinamik, kërkimet e audituesit për informacione mund të kryhen edhe gjatë gjithë angazhimit të auditimit.

Kërkimi i informacioneve nga funksioni i auditimit të brendshëm

A9. Nëse entiteti ka një funksion të auditimit të brendshëm funksional, kërkimi i informacionit nga personat e duhur brenda këtij funksioni, mund të japin informacion të dobishëm për audituesit për njohjen dhe kuptimin e entitetit dhe të mjedisit të tij dhe, për të identifikuar e vlerësuar rreziqet e anomalisë materiale në nivelet e pasqyrave financiare dhe të pohimit. Gjatë punës së kryer, auditimi i brendshëm merr njohuri për operacionet e entitetit dhe rrezikun e veprimtarisë, dhe mund të ketë siguruar gjetje nga puna e kryer, sic janë mangësitë e identifikuara të kontrolleve ose rreziqeve, të cilat mund të jenë input i rëndësishëm për njohjen e entitetit nga audituesi, vlerësimin e rrezikut të audituesit dhe aspekteve të tjera të auditimit. Prandaj, kërkesat për informacione bëhen nga audituesi për të vlerësuar nëse ai parashikon të përdorë ose jo punën e funksionit të auditimit të brendshëm, për të modifikuar natyrën ose afatet, ose për të zvogëluar shtrirjen e procedurave të auditimit që do të kryhen.⁶ Kërkesat për informacione të një rëndësie të veçantë, mund të kenë të bëjnë me çështjet që funksioni i auditimit të brendshëm ka ngritur me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe rezultatet e vetë procesit të vlerësimit të rrezikut të funksionit.

A10. Nëse, bazuar në përgjigjet e dhëna kundrejt pyetjeve të audituesit, duket se ka gjetje që mund të jenë të rëndësishme për raportimin financiar dhe auditimin e entitetit, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme të lexojë raportet përkatëse të funksionit të auditimit të brendshëm. Shembuj të raporteve të funksionit të auditimit të brendshëm që mund të jenë të përshtatshme, janë strategjia e funksionit dhe dokumentet e planifikimit dhe raportet që janë përgatitur për drejtimin ose për personat e ngarkuar me qeverisjen, të cilat

⁶ Kërkesat përkatëse janë të përfshira në SNA 610 (Rishikuar në vitin 2013)

përshkruajnë gjetjet e kontrolleve të funksionit të auditimit të brendshëm.

- A11. Për më tepër, në pajtueshmëri me SNA 240⁷, nëse funksioni i auditimit të brendshëm i jep informacion audituesit në lidhje me ndonjë mashtrim ekzistues, të dyshuar ose të supozuar, audituesi i merr parasysh këto informacione gjatë identifikimit të rrezikut të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit.
- A12. Individë të përshtatshëm brenda funksionit të auditimit të brendshëm ndaj të cilave bëhen kërkesat për të marrë informacion janë ata që, sipas gjykimit të audituesit, kanë njohuritë, përvojën dhe autoritetin e duhur, siç janë shefi ekzekutiv i auditimit të brendshëm, ose në varësi të rrethanave, personeli tjetër brenda funksionit. Audituesi gjithashtu mund ta konsiderojë të përshtatshme që të realizojë takime të herëpashershme me këta individë.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik (Ref: Para 6(a))

- A13. Audituesit e entiteteve të sektorit publik shpesh herë kanë përgjegjësi shtesë lidhur me kontrollin e brendshëm dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Kërkesat për informacione ndaj individëve të duhur në funksionin e auditimit të brendshëm mund të ndihmojnë audituesin për identifikimin e rreziqeve të papajtueshmërisë materiale me ligjet dhe rregullat e zbatueshme, dhe rrezikun e mangësive të kontrollit të brendshëm në raportimet financiare.

Procedura analitike (Ref: Para. 6(b))

- A14. Procedurat analitike të kryera si procedura të vlerësimit të rrezikut mund të zbulojnë aspekte të entitetit, me të cilat audituesi nuk ka qenë i njohur dhe mund ta ndihmojnë atë në vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale për qëllime të krijimit të një baze për hartimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve. Procedurat analitike të kryera si procedura të vlerësimit të rrezikut mund të përfshijnë të dhëna financiare dhe jo-financiare, për shembull marrëdhënia që ekziston midis shitjeve dhe metrave katrorë të hapësirës së shitjeve ose volumit të mallrave të shitura.
- A15. Procedurat analitike mund të ndihmojnë në identifikimin e ekzistencës së transkioneve ose ngjarjeve të pazakonta dhe shumave, përpjesëtimeve dhe prirjeve që kanë ndikim në çështje që kanë të bëjnë me auditimin. Marrëdhëniet e pazakonta ose të papritura që janë vënë re mund ta ndihmojnë audituesin në identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale, veçanërisht rreziqeve të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit.
- A16. Sidoqoftë, kur këto procedura analitike përdorin të dhëna të bashkuara në një nivel të lartë (e cila mund të jenë situata kur procedurat analitike ekzekutohen si

⁷ SNA 240, paragrafi 20

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

procedura të vlerësimit të rrezikut), rezultatet e këtyre procedurave analitike japin vetëm një shenjë të përgjithshme të faktit nëse mund të ekzistojë një anomali materiale. Për pasojë, marrja në konsideratë e informacionit tjetër të mbledhur gjatë identifikimit të rreziqeve të anomalisë materiale së bashku me rezultatet e këtyre procedurave analitike mund ta ndihmojë audituesin në njohjen dhe vlerësimin e rezultateve të këtyre procedurave.

Konsideratatë Veçanta për Entitetet e Vogla

A17. Disa entitete të vogla mund të mos kenë informacion financiar të ndërmjetëm ose mujor që mund të përdoret për qëllime të procedurave analitike. Në rrethana të tilla, ndonëse audituesi mund të kryejë procedura analitike të kufizuara për qëllime të planifikimit të auditimit ose të sigurojë informacion nëpërmjet kërkesave për informacion, audituesi do të planifikojë kryerjen e procedurave analitike për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalisë materiale kur është disponibël një projekt i hershëm i pasqyrave financiare të entitetit.

Observimet dhe Inspektimet (Ref: Para.6(c))

A18. Vëzhgimi dhe inspektimi mund të mbështesë kërkesat për informacion që i bëhen drejtimit dhe personave të tjerë dhe gjithashtu, jep informacion mbi entitetin dhe mjedisin e tij. Shembuj të procedurave të tilla të auditimit përfshijnë vëzhgimin ose inspektimin e aspekteve të mëposhtme:

- Operacioneve të entitetit.
- Dokumenteve (siç janë planet e biznesit dhe strategjitë e veprimtarisë), regjistrimet dhe manualët e kontrollit të brendshëm.
- Raporteve të përgatitura nga drejtimi (siç janë raportet tremujore të drejtimit dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme) dhe nga ata që janë të ngarkuar me qeverisjen (siç janë procesverbalet e mbledhjeve të bordit të drejtorëve).
- Të pajisjeve dhe ambjenteve të entitetit.

Informacion i marrë në periudhat e mëparshme (Ref: Para.9)

A19. Eksperiencia e mëparshme e audituesit me entitetin dhe procedurat e auditimit të kryera gjatë auditimeve të mëparshme mund t'i sigurojnë audituesit informacion për çështje të tilla si:

- Anomali të e ndodhura në të kaluarën dhe për faktin nëse ato janë korrigjuar ose jo në kohë.
- Natyrën e entitetit dhe mjedisin e tij, si edhe kontrollin e brendshëm të

entitetit (duke përfshirë mangësitë në kontrollin e brendshëm).

- Ndryshimet e rëndësishme që mund të kenë ndodhur brenda entitetit ose në operacionet e tij që nga periudha e mëparshme financiare, ç'ka mund ta ndihmojë audituesin që të arrijë të njohë entitetin siç duhet për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalisë materiale.
- Ato lloje të veçanta të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera ose tepricat e llogarive (dhe informacionet shpjeguese përkatëse) ku audituesi has vështirësi në kryerjen e procedurave të nevojshme të auditimit, si për shembull, për shkak të kompleksitetit të tyre.

A20. Audituesit i kërkohet që të përcaktojë nëse informacioni i marrë gjatë auditimeve të periudhave të mëparshme është i përshtatshëm, në ato raste kur audituesi synon ta përdorë këtë informacion për qëllime të auditimit aktual. Kjo ndodh për arsye se, për shembull, ndryshimet në mjedisin e kontrollit mund të kenë ndikim në përshtatshmërinë e informacionit të marrë gjatë auditimit të vitit të mëparshëm. Për të përcaktuar nëse kanë ndodhur ndryshime që kanë ndikim në përshtatshmërinë, për auditimin aktual, të informacioneve të marra në të kaluarën, audituesi duhet të kërkojë informacione dhe të kryejë procedura të tjera auditimi të përshtatshme, siç janë për shembull kontrollet hap-pas-hapi të sistemeve.

Diskutime mes Grupit të Angazhimit (Ref: Para.10)

A21. Diskutimi me anëtarët e grupit të angazhimit në lidhje me ndjeshmërinë që kanë pasqyrat financiare të entitetit ndaj anomalisë materiale:

- Krijon një mundësi për pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të angazhimit që kanë më shumë përvojë, përfshirë dhe ortakun e angazhimit, me qëllim që ata të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre sipas këndvështrimit që kanë për njohjen e entitetit.
- Lejon që anëtarët e grupit të shkëmbejnë informacione rreth rreziqeve të biznesit ndaj të cilave ekspozohet entiteti, si edhe për të përcaktuar si dhe ku mund të dyshohet që pasqyrat financiare të përmbajnë anomali materiale për shkak të mashtrimit ose gabimit.
- Ndihmon anëtarët e grupit të angazhimit të arrijnë të njohin më mirë ekzistencën e mundësive që pasqyrat financiare do të përmbajnë anomali materiale, në ato pjesë të auditimit që ju janë cakuar atyre dhe të kuptojnë mënyrën se si mund të ndikojnë rezultatet e procedurave të auditimit që ata kryejnë, në aspektet e tjera të auditimit, përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me përcaktimin e natyrës, e afateve dhe të shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit.

- Krijon një bazë rreth së cilës anëtarët e grupit të angazhimit të komunikojnë dhe ndajnë midis tyre informacionet e marra gjatë auditimit, të cilat mund të kenë ndikim në vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale ose në procedurat e auditimit që kryhen për të trajtuar rreziqet.

SNA 240 përmban kërkesa dhe udhëzime të mëtejshme në lidhje me diskutimet me anëtarët e grupit të angazhimit për rreziqet e mashtrimit.⁸

A22. Si pjesë e diskutimeve mes grupit të angazhimit të kërkuar nga paragrafi 10, marrja në konsideratë e kërkesës së kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar për të dhënë informacione, ndihmon në identifikimin me herët gjatë auditimit, se ku mund të ketë rreziqe të anomalisë materiale në lidhje me informacionet shpjeguese të dhëna. Shembuj të çështjeve që grupi i angazhimit mund të diskutojë përfshijnë:

- Ndryshimet në kërkesat e raportimit financiar, që mund të rezultojnë në informacione shpjeguese konsiderueshëm të reja ose të rishikuara;
- Ndryshimet në mjedisin e entitetit, gjendjen financiare ose aktivitetet që mund të rezultojnë në informacione shpjeguese konsiderueshëm të reja ose të rishikuara, për shembull një kombinim i rëndësishëm i biznesit gjatë periudhës së auditimit;
- Informacionet shpjeguese për të cilat sigurimi i evidencës së nevojshme të auditimit mund të ketë qenë i vështirë në të kaluarën; dhe
- Informacionet shpjeguese në lidhje me çështje komplekse, përfshirë ato çështje që kërkojnë gjykim të rëndësishëm nga drejtimi përsa i përket informacionit shpjegues që duhet të jepet.

A23. Jo gjithmonë është e nevojshme ose praktike që të përfshihen në një diskutim të vetëm të gjithë anëtarët e grupit të angazhimit (si për shembull, në auditimet që shtrihen në disa vendndodhje), dhe as nuk është e nevojshme që të gjithë anëtarët të kenë njohje të plotë për të gjitha aspektet e auditimit. Partneri i angazhimit mund të diskutojë çështje të caktuara me anëtarët kryesorë të grupit të angazhimit, nëse konsiderohet e nevojshme, me ata anëtarë të cilët kanë aftësi të veçanta dhe njohuri lidhur me çështjet, si dhe me ata anëtarë të cilët janë përgjegjës për auditimet e entiteve të kontrolluara, ndërsa mund të delegojë diskutimet me anëtarët e tjerë, duke patur parasysh shtrirjen e diskutimit brenda grupit të angazhimit të konsideruar si të nevojshme. Një plan komunikimi, i aprovuar nga ortaku i angazhimit, mund të jetë i nevojshëm.

Konsideratatë Veçanta për Entitetet e Vogla

⁸SNA240,paragrafi 16.

A24. Në përgjithësi auditimet e entiteteve të vogla kryhen vetëm nga partneri i angazhimit (që mund të jetë një profesionist i praktikës i vetëm). Në raste të tilla, është partneri i angazhimit, i cili duke qënë se e ka kryer vetë planifikimin e auditimit, është përgjegjës për të marrë në konsideratë ndjeshmërinë që kanë pasqyrat financiare të entitetit ndaj anomalisë materiale për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Njohja e Kërkuar e Entitetit dhe Mjedisit të tij, Përfshirë Kontrollin e Brendshëm të Entitetit dhe Mjedisit të tij

Industria, Rregullatorët dhe Faktorët të tjerë të Jashtëm (Ref: Paragrafi 11 (a))

Faktorët e Industrisë

A25. Faktorët përkatës të industrisë përfshijnë kushtet e industrisë, siç janë mjedisi konkurrues, marrëdhëniet me furnitorët dhe klientët dhe zhvillimet teknologjike. Shembuj të çështjeve që audituesi mund të marrë në konsideratë përfshijnë:

- Tregu dhe konkurenca, ku përfshihen kërkesa, kapaciteti dhe çmimet konkurruese.
- Karakteri ciklik apo sezonal i aktivitetit.
- Teknologjia e prodhimit që lidhet me produktet e entitetit.
- Furnizimi me energji dhe kosto e saj.

A26. Industria në të cilin operon entiteti bëhet shkas për ekzistencën e rreziqeve specifike të anomalive materiale, që rrjedhin nga natyra e biznesit ose shkalla e rregullimit të tij. Për shembull, kontratat afatgjata mund të përfshijnë vlerësime të rëndësishme të të ardhurave dhe kostove, të cilat bëhen shkas për rreziqet e anomalisë materiale. Në të tilla raste, audituesi shqyrton faktin nëse në grupin e angazhimit janë përfshirë anëtarë që kanë njohuri dhe eksperiencë të mjaftueshme për këto fusha⁹.

Faktorët Rregullatorë

A27. Faktorët përkatës rregullatorë përfshijnë mjedisin rregullator. Mjedisi rregullator përmbledh midis të tjerash kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe mjedisin ligjor dhe politik. Shembuj të çështjeve që audituesi mund të marrë në konsideratë përfshijnë:

- Parimet e kontabilitetit dhe praktikat specifike të sektorit të ekonomisë.

⁹SNA220, *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 14.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Kuadri rregullator për një sektor ekonomie të rregulluar.
- Legjislacioni dhe rregulloret që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në funksionimin e entitetit, përfshirë aktivitetet e mbikqyrjes direkte.
- Tatimi (i shoqërive tregtare dhe të tjera).
- Politikat aktuale të qeverisë që ndikojnë në realizimin e biznesit të entiteteve sic mund të jenë politikat monetare, duke përfshirë kontrollin e kurseve të këmbimit, nxitjet fiskale ose financiare (për shembull, programet e ndihmave qeveritare) dhe tarifatat ose politikatat e kufizimeve tregtare.
- Kërkesat mjedisore që ndikojnë industrinë dhe biznesin e entitetit.

A28. SNA 250 (i rishikuar) përfshin disa kërkesa specifike që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm për entitetin dhe industrinë ose sektorin ku ai vepron.¹⁰

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A29. Për auditimet e entiteteve të sektorit publik, ligji, rregulloret ose autoritete të tjera mund të kenë ndikim në veprimtarinë e entitetit. Për rrjedhojë elementë të tillë janë shumë të rëndësishëm gjatë njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij.

Faktorët e Tjerë të Jashtëm

A30. Shembuj të faktorëve të tjerë të jashtëm të cilët kanë ndikim tek entiteti dhe që audituesi mund t'i marrë në konsideratë përfshijnë kushtet e përgjithshme të ekonomisë, normat e interesit dhe mundësia e financimeve, si dhe inflacioni ose rivlerësimi i monedhës.

Natyra e entitetit (Ref: Para. 11(b))

A31. Njohja e natyrës së entitetit i jep mundësi audituesit që të kuptojë çështje të tilla si:

- Nëse entiteti ka një strukturë komplekse, për shembull, me filiale ose entitete të tjera të kontrolluara të vendosura në shumë vende. Strukturat komplekse shpesh paraqesin çështje që mund të bëhen shkas për rrezikun e anomalive materiale. Çështje të tilla mund të jetë fakti nëse emri i mirë, pjesëmarrja në sipërmarrjet e përbashkëta, investime ose entitete për qëllime të veçanta është llogaritur siç duhet.

¹⁰SNA250 (i rishikuar), Marrja në Konsideratë e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare, paragrafi 13.

- Pronësia dhe marrëdhëniet midis pronarëve dhe njerëzve ose entiteteve të tjerë. Kjo njohje ndihmon për të përcaktuar nëse transaksionet me palët e lidhura janë identifikuar dhe pasqyruar siç duhet. SNA 550¹¹ vendos kërkesa dhe jep udhëzime për sa i takon kujdesit që duhet të tregojë audituesi në lidhje me palët e lidhura.

A32. Shembuj të çështjeve që audituesi mund të marrë në konsideratë gjatë njohjes së natyrës së entitetit përfshijnë:

- Operacionet e biznesit, siç janë:
 - Natyra e burimeve të të ardhurave, produkteve ose shërbimeve, përfshirë pjesëmarrjen në tregtinë elektronike siç janë shitjet dhe aktivitetet e marketingut nëpërmjet internetit.
 - Realizimi i operacioneve (për shembull, fazat dhe metodat e prodhimit, ose aktivitetet e ekspozuara ndaj rreziqeve mjedisore).
 - Aleancat, sipërmarrjet e përbashkëta, dhe aktivitetet që bazohen në shërbime që kontrahohen me të.
 - Shpërndarja gjeografike dhe segmentimi i sektorit të ekonomisë.
 - Vendndodhja e paisjeve të prodhimit, magazinave, dhe zyrave, si dhe vendndodhja dhe sasitë e inventarëve.
 - Klientët kryesorë dhe furnizuesit e rëndësishëm të mallrave dhe shërbimeve, marrëveshjet e punësimit (përfshirë ekzistencën e kontratave me sindikatat, pensione dhe përfitimeve të tjera pas-punësimit, marrëveshjeve për pjesëmarrje në aksione ose në bonuset nxitëse, dhe rregullave të qeverisë që lidhen me çështjet e punësimit).
 - Aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit dhe shpenzimet e tyre.
 - Transaksionet me palët e lidhura.
- Investimet dhe aktivitetet investuese, siç janë:
 - Blerjet ose shitjet e planifikuara apo të ndodhura kohët e fundit.
 - Investimet dhe shitja e letrave me vlerë dhe e huave.
 - Aktivitetet e investimeve të kapitalit.

¹¹SNA550, *Palët e Lidhura*.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Investimet në entitetet e pa-konsoliduara, përfshirë bashkëpronësitë, pjesëmarrjet e përbashkëta dhe entitetet për qëllime të veçanta.
- Financimet dhe aktivitetet financuese, siç janë:
 - Filialet kryesore dhe entitetet e lidhura, përfshirë strukturat e konsoliduara dhe jo-të konsoliduara.
 - Struktura e borxhit dhe kushtet përkatëse, përfshirë marrëveshjet financiare dhe marrëveshjet e qeradhënies jashtë-bilancit.
 - Pronarët përfitues (vendas, të huaj, reputacioni dhe eksperiencat e biznesit) dhe palët e lidhura.
 - Përdorimi i instrumentave financiarë derivativë.
- Raportimi financiar, siç janë:
 - Parimet kontabël dhe praktikat specifike të sektorit të ekonomisë, përfshirë kategoritë kryesore specifike të sektorit të ekonomisë (për shembull, huatë dhe investimet për bankat, ose kërkimi dhe zhvillimi për kompanitë farmaceutike).
 - Praktikrat e njohjes së të ardhurave.
 - Kontabiliteti me vlerën e drejtë.
 - Aktivitet, detyrimet dhe transaksionet në monedhë të huaj.
 - Kontabiliteti i transaksioneve të jashtëzakonshme ose komplekse duke përfshirë ato në fusha të diskutueshme apo të reja (për shembull, kontabiliteti i kompesimit të bazuar në aksione).

A33. Ndryshimet e rëndësishme të ndodhura në entitet në krahasim me periudhat e mëparshme mund të behen shkas për krijimin, ose ndryshimin, e rreziqeve të anomalisë materiale.

Natyra e Entiteve për Qëllime të Veçanta

A34. Një entitet për qëllime të veçanta (në disa raste referuar me termin mjet për qëllime të veçanta) është një entitet që zakonisht krijohet për një qëllim të kufizuar dhe mirë-përcaktuar, sic mund të jetë dhënia me qera ose kthimi në letra me vlerë i aktiveve financiare, ose kryerja e aktiviteteve të kërkimit ose zhvillimit. Entiteti mund të ketë formën e një korporate, trusti, ortakërie ose të një entiteti më vete. Entiteti në emër të të cilit është krijuar entiteti për qëllime të veçanta, mund t'i transferojë këtij të fundit shpesh aktive (për shembull, si pjesë e një transaksioni çregjistrimi që

përfshin aktivet financiare), ka të drejtën e përdorimit të aktiveve të tij, ose kryen shërbime për të, ndërsa palët e tjera mund të sigurojnë fonde për këtë entitet. Siç përcaktohet edhe në SNA 550, në disa rrethana, një entitet për qëllime të veçanta mund të jetë një palë e lidhur e entitetit.¹²

- A35. Kuadro të raportimit financiar shpesh përcaktojnë kushte të detajuara për nivelin e kontrollit të entitetit për qëllime të veçanta, ose rrethana në të cilat entiteti për qëllime të veçanta duhet të konsolidohet. Interpretimi i kërkesave të kuadrove të tillë shpesh kërkon një njohje në detaje të marrëveshjeve përkatëse ku është i përfshirë entiteti për qëllime të veçanta.

Politikat Kontabël që ka Zgjedhur dhe ka Zbatuar Entiteti (Ref:Para.11(c))

- A36. Njohja e politikave kontabël që entiteti ka zgjedhur dhe ka zbatuar përfshin çështje të tilla si:

- Metodrat që ka përdorur entiteti për të analizuar transaksionet e rëndësishme dhe të pazakonta.
- Efektin e politikave të rëndësishme kontabël në fushat e diskutueshme ose të veçanta, në të cilat ka mangësi rregullimesh ose konsensusi.
- Ndryshimet që kanë ndodhur në politikat kontabël të entitetit.
- Standardet e raportimit financiar dhe ligjet dhe rregullat që janë të reja për entitetin dhe kur dhe si entiteti do t'i adoptojë këto kërkesa.

Objektivat, Strategjitë dhe Rreziqet që lidhen me Biznesin(Ref: Para. 11(d))

- A37. Entiteti e zhvillon veprimtarinë e tij brenda sektorit, kuadrit rregullator dhe faktorëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm. Për t'iu përgjigjur këtyre faktorëve, drejtimi i entitetit ose ata që janë të ngarkuar me qeverisjen caktojnë objektivat, të cilat janë planet e përgjithshme për entitetin. Strategjitë janë metodat me anën e të cilave drejtimi synon të arrijë objektivat. Objektivat dhe strategjitë e entitetit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.A38.Rreziku i veprimtarisë është më i gjerë se rreziku i anomalive materiale në pasqyrat financiare, edhe pse ai e përfshin këtë të fundit. Rreziku i veprimtarisë mund të jetë si rrjedhojë e ndryshimit ose e kompleksitetit. Mosnjohja e nevojës për ndryshim, gjithashtu mund të çojë në një rrezik. Rreziku i veprimtarisë mund të vijë për shembull nga:

- Fakti që zhvillimi i një produkti ose shërbimi të ri dështon;
- Një treg i cili, edhe pse mund të jetë zhvilluar në mënyrë të sukseshme, është i

¹²SNA550,paragrafiA7.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

papërshtatshëm për të mbështetur një produkt ose shërbim; ose

- Të metat në një produkt ose shërbim që mund të çojnë në krijimin e detyrimeve dhe rrezik reputacioni.

A39. Njohja e rreziqeve të veprimtarisë me të cilat përballet entiteti rrit mundësinë e identifikimit të rreziqeve të anomalisë materiale, duke qënë se shumica e rreziqeve të veprimtarisë kanë pasoja financiare dhe si rrjedhim, ndikojnë në pasqyrat financiare. Megjithatë, audituesit nuk i duhet që të identifikojë të gjitha rreziqet e veprimtarisë sepse jo të gjitha rreziqet e veprimtarisë bëhen shkas për rreziqe të anomalisë materiale.

A40. Shembuj të çështjeve që audituesi mund të marrë në konsideratë gjatë njohjes së objektivave, strategjive dhe rreziqeve që lidhen me biznesin të cilat mund të çojnë në rrezik të anomalisë materiale në pasqyrat financiare përfshijnë:

- Zhvillimet e industrisë (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, rasti kur entiteti nuk ka personelin apo ekspertizën e duhur për të trajtuar ndryshimet që kanë ndodhur në industri).
- Produktet dhe shërbimet e reja (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, rasti kur rriten detyrimet ndaj produktit).
- Zgjerimin e biznesit (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, në rastet kur kërkesa nuk është parashikuar saktë).
- Kërkesat e reja kontabël (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, zbatimi në mënyrë jo të plotë apo të duhur, apo rritja e kostove).
- Kërkesat rregullatore (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, në rastet kur ka një ekspozim të shtuar ligjor).
- Kërkesat aktuale dhe perspektive të financimeve (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, humbja e financimeve për shkak të paaftësisë së biznesit për të përmbushur kërkesat).
- Përdorimi i TI (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, rasti kur sistemet dhe proceset janë jo të përshtatshme).
- Efektet e zbatimit të strategjive, veçanërisht ato efekte që do të çojnë në kërkesa të reja kontabël (një rrezik potencial i lidhur me biznesin mund të jetë për shembull, zbatimi jo i plotë ose i papërshtatshëm).

A41. Rreziku i veprimtarisë ka pasoja të menjëhershme në rrezikun e anomalisë në klasat e transaksioneve, tepricat e llogarisë dhe informacionet e dhëna në nivel

pohimi ose në nivel të pasqyrave financiare. Për shembull, rreziku i veprimtarisë që vjen nga një klient i cili është kontraktues i dorës së parë, mund të rrisë rrezikun e anomalive që kanë të bëjnë me vlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Megjithatë, i njëjti rrezik, veçanërisht në kombinim me një ekonomi të kontraktuar, mund të ketë gjithashtu, pasoja afatgjata, të cilat audituesi i merr parasysh kur vlerëson përshtatshmërinë e hipotezës së vijimësisë. Për rrjedhojë, gjykimi nëse rreziku i veprimtarisë bëhet shkas për anomali materiale apo jo duhet bërë nisur nga rrethanat e entitetit. Shembuj të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë për rreziqe të anomalisë materiale janë dhënë në Shtojcën 2.

- A42. Si rregull, i takon drejtimit të identifikojë rreziqet e veprimtarisë dhe të përcaktojë mënyrën e trajtimit të tyre. Ky proces i vlerësimit të rrezikut është pjesë përbërëse e funksionit të kontrollit të brendshëm, dhe është trajtuar në paragrafin 15 dhe paragrafët A88–A89.

Konsideratatë Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

- A43. Në auditimet e entiteteve të sektorit publik, “objektivat e drejtimit” ndikohen nga shqetësimet lidhur me përgjegjësinë publike dhe përfshijnë objektiva të cilat e kanë burimin e tyre në ligj, rregullore ose autoritet tjetër.

Vlerësimi dhe Rishikimi i Performancës Financiare të Entitetit(Ref: Para.11 (e))

- A44. Drejtimi dhe të tjerët vlerësojnë dhe rishikojnë ato aspekte që i konsiderojnë të rëndësishme. Matësit e performancës, qofshin të brendshëm apo të jashtëm, kanë ndikime mbi entitetin. Këto ndikime mund ta nxisin drejtimin të ndërmarrë veprime për të rritur performancën e veprimtarisë ose për të keqparaqitur pasqyrat financiare. Prandaj, njohja e treguesve të vlerësimit të performancës së entitetit e ndihmon audituesin që të kuptojë nëse ndikimet për të arritur objektivat e performancës mund ta çojnë drejtimin të bëjë veprime të cilat shtojnë rreziqet e anomalisë materiale, përfshirë rreziqet për shkak të mashtrimit. Shiko SNA 240 për sa i përket kërkesave dhe udhëzimeve në lidhje me rreziqet e mashtrimit.
- A45. Vlerësimi dhe rishikimi i performancës financiare nuk është i njëjtë me vëzhgimin e kontrolleve (që është trajtuar si komponent i kontrollit të brendshëm në paragrafët A110–A121), megjithëse qëllimet e tyre duket se mbivendosen tek njëri tjetri.
- Vlerësimi dhe rishikimi i performancës ka lidhje me faktin nëse performanca e veprimtarisë së entitetit arrin objektivat e vendosura nga drejtimi (apo nga palët e treta).
 - Vëzhgimi i kontrolleve është i lidhur veçanërisht me funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

Megjithatë, në disa raste, treguesit e performancës japin gjithashtu informacione të cilat bëjnë të mundur që drejtimi të identifikojë mangësitë e kontrollit të brendshëm.

- A46. Shembuj të informacionit që gjenerohet nga brenda entitetit dhe përdoret nga drejtimi për të vlerësuar dhe rishikuar performancën financiare dhe që mund të merret në konsideratë nga audituesi, përfshijnë:
- Treguesit kryesorë të performancës (financiarë dhe jofinanciarë) dhe raportet kryesore, prirjet dhe statistikat operacionale.
 - Analizat e performancës financiare periudhë pas periudhe.
 - Buxhetet, parashikimet, analizat e shmangies, informacionet e segmentuara, raportet e performancës në nivel departamenti ose në çfarëdo niveli tjetër.
 - Treguesit e performancës së punonjësve dhe politikat nxitëse të kompensimit.
 - Krahasimet e performancës së entitetit me atë të konkurrentëve.
- A47. Palët e jashtme mundet gjithashtu, të vlerësojnë dhe të rishikojnë performancën financiare të entitetit. Për shembull, informacioni i jashtëm në formën e raporteve të analistëve dhe raporteve të agjencive kredituese, mund të përbëjë informacion të dobishëm për audituesin. Raporte të tilla shpesh mund të sigurohen nga entiteti që auditohet.
- A48. Vlerësimet e brendshme mund të nxjerrin në pah rezultate të papritura ose prirje të cilat kërkojnë që drejtimi të përcaktojë shkaqet e tyre dhe të marrë masa korrigjuese (përfshirë në disa raste, zbulimin dhe korrigjimin në kohë të anomalive). Gjithashtu, vlerësimet e performancës mund t'i tregojnë audituesit për ekzistencën e rrezikut të anomalive në lidhje me informacionin e pasqyrave financiare. Për shembull, matësit e performancës mund të tregojnë që entiteti ka një rritje ose përfitueshmëri të shpejtë, të pazakontë, në krahasim me entitetet e tjera të të njëjtit sektor. Një informacion i tillë, veçanërisht nëse kombinohet me faktorë të tjerë, siç janë bonuset apo shpërblimet nxitëse, që janë të bazuara në performancë, tregon për një rrezik potencial të paragjykitimit të drejtimit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

- A49. Entitetet e vogla zakonisht nuk kanë procese për vlerësimin dhe rishikimin e performancës financiare. Kërkimi i informacionit nga drejtimi mund të tregojë që ai mbështetet në disa tregues kryesorë për vlerësimin e performancës financiare dhe marrjen e masave të duhura. Nëse nga kërkimi i një informacioni të tillë rezulton që ka

mangësi të treguesve të performancës ose rishikimit, atëherë mund të kemi të bëjmë me një rrezik të rritur të anomalive që nuk janë zbuluar dhe korrigjuar.

Kontrolli i brendshëm i entitetit (Ref: Para.12)

- A50. Njohja e kontrollit të brendshëm e ndihmon audituesin për të identifikuar llojet e anomalive potenciale dhe faktorët që ndikojnë në rreziqet e anomalisë materiale, si dhe për të planifikuar natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit.
- A51. Materiali në vijim, për tu zbatuar lidhur me kontrollin e brendshëm, paraqitet në katër seksione, si më poshtë:
- Natyra e Përgjithshme dhe Karakteristikat e Kontrollit të Brendshëm.
 - Kontrollat që Lidhen me Auditimin.
 - Natyra dhe Shtrirja e Njohjes së Kontrolleve Përkatëse.
 - Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm.

Natyra e Përgjithshme dhe Karakteristikat e Kontrollit të Brendshëm.

Qëllimi i Kontrollit të Brendshëm

- A52. Kontrolli i brendshëm hartohet, zbatohet dhe ka si qëllim të trajtojë rreziqet e identifikuar të veprimtarisë, të cilat kërcënojnë arritjen e ndonjë prej objektivave të entitetit që ka lidhje me:
- Besueshmërinë e raportimit financiar të entitetit;
 - Efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve të tij; dhe
 - Pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

Mënyra si planifikohet dhe zbatohet kontrolli i brendshëm varet nga madhësia dhe kompleksiteti i entitetit.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

- A53. Entitetet e vogla mund të përdorin mjete që janë më pak të strukturuar dhe procese e procedura më të thjeshta për të arritur objektivat e tyre.

Kufizimet e Kontrollit të Brendshëm

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- A54. Kontrolli i brendshëm, pavarësisht se sa efektiv është, jep vetëm një siguri të arsyeshme mbi arritjen e objektivave të entitetit për raportimin financiar. Mundësia e arritjes ndikohet nga kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm. Këto kufizime përfshijnë faktin që gjykimi njerëzor në vendimmarrje mund të jetë i gabuar, apo që kontrolli i brendshëm mund të dështojë si rezultat i gabimeve njerëzore. Për shembull, mund të ketë një gabim në dizenjimin, ose ndryshimin, e një kontrolli. Në të njëjtën mënyrë, funksionimi i një kontrolli mund të mos jetë efektiv, siç mund të jetë rasti kur informacioni i prodhuar për qëllime të kontrollit të brendshëm (për shembull, një raport i veçantë) nuk përdoret në mënyrë efektive sepse individit përgjegjës për të rishikuar informacionin nuk e kupton qëllimin e tij ose dështon në ndërmarrjen e veprimeve të duhura.
- A55. Për më tepër, kontrollet mund të shmangen nga ekzistenca e një marrëveshje të fshehtë midis dy ose më shumë personave, ose për shkak të një anashkalimi të papërshtatshëm të kontrollit të brendshëm nga drejtimi. Për shembull, drejtimi mund të bëjë një marrëveshje dytësore me klientët për të ndryshuar termat dhe kushtet e kontratës standarde të shitjes që përdor entiteti, çka mund të çojë në njohjen e një të ardhure të gabuar. Gjithashtu, kontrollet e përfshira në programet kompjuterike që janë modeluar për të identifikuar dhe raportuar transaksione që tejkalojnë kufijtë e specifikuar të kreditimit mund të shpërfillen ose të nxirren jashtë përdorimit.
- A56. Gjithashtu, gjatë dizenjimit dhe zbatimit të kontrolleve, drejtimi mund të bëjë gjykime lidhur me natyrën dhe shtrirjen e kontrolleve që ai zgjedh të zbatojë, dhe natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve që ai zgjedh të konsiderojë.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

- A57. Entitetet e vogla shpesh kanë një numër të pakët punonjësish, çka e kufizon shkallën e zbatimit të ndarjes së detyrave. Megjithatë, në një entitet të vogël që drejtohet nga pronari, pronari-drejtues është në gjëndje që të ushtrojë një mbikëqyrje më efektive sa sa ajo në një entitet të madh. Kjo mbikëqyrje kompenson mundësitë e kufizuara për ndarje detyrash..A58. Nga ana tjetër, pronari-drejtues është në gjëndje që të anashkalojë kontrollet sepse sistemi i kontrollit të brendshëm është më pak i strukturuar. Ky fakt merret parasysh nga audituesi gjatë identifikimit të rreziqeve të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit.

Ndarja e Kontrollit të Brendshëm në Elementë Përbërës

- A59. Ndarja e kontrollit të brendshëm në pesë elementët përbërës që trajtohen në vijim, për qëllime të SNA-ve, jep një kuadër të dobishëm për audituesit për të vlerësuar mënyrën se si mund të ndikojnë në auditim aspekte të ndryshme të kontrollit të brendshëm të entitetit:

- (a) Mjedisi i kontrollit;
- (b) Procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit;
- (c) Sistemi i informacionit, përfshirë proceset përkatëse të veprimtarisë, që kanë të bëjnë me raportimin financiar dhe komunikimin;
- (d) Veprimtaritë e kontrollit; dhe
- (e) Vëzhgimi i kontrolleve.

Ndarja nuk është e nevojshme të reflektojë mënyrën sipas të cilës entiteti dizenjon, zbaton dhe mbron kontrollin e brendshëm, apo se si entiteti klasifikon një element përbërës të tij. Audituesit mund të përdorin terminologji apo kuadro që ndryshojnë nga ato që janë dhënë në këtë SNA, për të përshkruar aspekte të ndryshme të kontrollit të brendshëm dhe ndikimet e tyre në auditim, me kusht që të gjejnë trajtimin e duhur të gjithë elementët përbërës të përshkruar në këtë SNA.

- A60. Materiali zbatues që ka të bëjë me pesë elementët përbërës dhe lidhjes që ato kanë me auditimin e pasqyrave financiare trajtohet në paragrafët A77-A121 në vijim. Shtojca 1 paraqet shpjegime të mëtejshme lidhur me këta elementë përbërës të kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat e Elementëve Manualë dhe të Automatizuar të Kontrollit të Brendshëm që Lidhen me Vlerësimin që Audituesi Bën për Rrezikun

- A61. Sistemi i kontrollit të brendshëm të një entiteti përmban elementë manualë dhe shpeshherë edhe elementë të automatizuar. Karakteristikat e elementëve manualë dhe të automatizuar janë të lidhur me vlerësimin që audituesi bën për rrezikun dhe procedurat e mëtejshme të auditimit të bazuara mbi këtë vlerësim.
- A62. Përdorimi në kontrollin e brendshëm i elementëve manualë ose të automatizuar ndikon gjithashtu, në mënyrën me të cilën transaksionet iniciohen, regjistrohen, përpunohen dhe raportohen:
- Kontrollat në një sistem manual mund të përfshijnë procedura të tilla si miratimin dhe rishikimin e transaksioneve, rakordimet dhe ndjekjen e zërave të rakorduar. Nga ana tjetër, një entitet mund të përdorë procedurat e automatizuara për të iniciuar, regjistruar, përpunuar dhe raportuar transaksionet, duke bërë që regjistrimet në formatin elektronik të zëvendësojnë dokumentet në letër.
 - Kontrollat në sistemet TI konsistojnë në një kombinim të kontrolleve të automatizuar (për shembull, kontrollat e përfshira në programet kompjuterike) me kontrollat manualë. Përveç kësaj, kontrollat manuale mund të jenë të

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

pavarura nga sistemi TI, mund të përdorin informacionin e prodhuar nga sistemi TI, ose mund të kufizohen vetëm në vëzhgimin e funksionimit efektiv të TI dhe të kontrolleve të automatizuara dhe në bërjen e përjashtimeve. Kur përdoret sistemi TI për të iniciuar, regjistruar, përpunuar ose raportuar transaksionet apo të dhëna të tjera financiare që përfshihen në pasqyrat financiare, sistemet dhe programet mund të përfshijnë kontrollet në lidhje me pohimet korresponduese për llogaritë materiale ose mund të jenë kritikë për funksionimin efektiv të kontrolleve manuale që varen nga sistemi TI.

Në një entitet, kombinimi i kontrolleve manuale me ato të automatizuara është në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të sistemit TI që ai përdor.

A63. Në përgjithësi, sistemi TI siguron përfitime për kontrollin e brendshëm të një entiteti duke i dhënë mundësi atij:

- Të zbatojë në mënyrë të vazhdueshme rregullat e paracaktuara të biznesit dhe të kryejë llogaritje komplekse gjatë përpunimit të volumeve të mëdha të transaksioneve ose të dhënave;
- Të rrisë koherencën, disponueshmërinë dhe saktësinë e informacionit;
- Të lehtësojë analizën shtesë të informacionit;
- Të rrisë aftësinë për të vëzhguar performancën e aktiviteteve, të politikave dhe procedurave të ndjekura nga entiteti;
- Të ulë rrezikun e shmangies së kontrolleve; dhe
- Të rrisë mundësinë për të patur një ndarje efektive të detyrave nëpërmjet zbatimit të kontrolleve të sigurisë në sistemet e zbatimeve, bazën e të dhënave dhe sistemet operative.

A64. Sistemi TI, gjithashtu krijon rreziqe specifike për kontrollin e brendshëm të entitetit, duke përfshirë, për shembull:

- Mbështetjen në sisteme ose programe që janë të pasakta në përpunimin e të dhënave, që përpunojnë të dhëna të gabuara ose të dyja bashkë.
- Hyrjen e paautorizuar në bazën e të dhënave, gjë që mund të çojë në prishjen ose në ndryshimin e pavend të tyre, përfshirë regjistrimin e transaksioneve të paautorizuara ose joekzistente, apo regjistrimin e tyre në mënyrë jo të saktë. Rrezik i veçantë paraqitet kur përdorues të shumtë kanë një bazë të dhënash të përbashkët.
- Mundësinë që personeli i TI të sigurojë privilegjin e hyrjes përtej atij të nevojshëm për të kryer detyrat e tyre duke cënuar kështu ndarjen e detyrave.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Ndryshimet e paautorizuara të të dhënave në skedarët kryesorë (master).
 - Ndryshimet e paautorizuara në sisteme ose programe.
 - Pamundësinë për të bërë ndryshimet e duhura në sisteme ose programe.
 - Ndërhyrje manuale të papërshtatshme.
 - Humbje potenciale e të dhënave ose paaftësi për të pranuar të dhëna në mënyrën e duhur.
- A65. Elementët manualë në kontrollin e brendshëm mund të jenë më të përshtatshëm, kur kërkohet mendim dhe gjykim siç janë rastet e rrethanave të mëposhtme:
- Transaksione të shumta, të pazakonshme ose joperiodike.
 - Në ato rrethana kur gabimet janë të vështira për t'u gjetur, paraprirë ose parashikuar.
 - Në rrethanat e ndryshuara që kërkojnë një reagim kontrolli përtej objektit të një kontrolli të automatizuar ekzistues.
 - Nivëzhgimin e efektshmërisë së kontrolleve të automatizuara.
- A66. Elementët manualë në kontrollin e brendshëm mund të jenë më pak të besueshëm se elementët e automatizuar, sepse ato mund të anashkalojnë lehtësisht, të injorohen ose të shpërfillen dhe gjithashtu, ata janë më të prirur ndaj gabimeve dhe pasaktësive. Prandaj, nuk mund të presupozohet vijimësi në zbatimin e një elementi manual të kontrollit. Elementët manualë të kontrollit mund të jenë më pak të përshtatshëm në rrethanat e mëposhtme:
- Kur ka një vëllim të madh ose përsëritje transaksionesh, ose në situatat kur gabimet e parashikuara mund të parandalohen apo të zbulohen vetëm nga parametrat e kontrollit të automatizuar.
 - Kur mënyrat specifike të kryerjes së kontrollit mund të planifikohen dhe të automatizohen në mënyrë të mjaftueshme.
- A67. Natyra dhe shkalla e rrezikut të kontrollit të brendshëm ndryshon në varësi të natyrës dhe karakteristikave të sistemit të informacionit të entitetit. Entiteti i përgjigjet rreziqeve që rrjedhin nga përdorimi i TI ose i elementëve manualë në kontrollin e brendshëm, duke vënë në funksionim kontrolle efektive bazuar në karakteristikat e sistemit të informacionit të entitetit.

Kontrollet që Lidhen me Auditimin

- A68. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis objektivave të entitetit dhe kontrolleve që ai zbaton në funksion të dhënies së një sigurie të arsyeshme për arritjen e tyre. Objektivat e entitetit dhe si rrjedhim, edhe të kontrolleve, kanë të bëjnë me raportimin financiar, operacionet dhe respektimin e rregullave. Megjithatë, jo të gjithë këto objektiva dhe kontrolle janë të përshtatshëm për vlerësimin që audituesi i bën rrezikut.
- A69. Faktorë që janë të përshtatshëm për gjykimin e audituesit, nëse një kontroll individual ose i kombinuar me të tjerët është i përshtatshëm për auditimin, përfshijnë çështje të tilla si:
- Materialiteti.
 - Rëndësia e rrezikut përkatës.
 - Madhësia e entitetit.
 - Natyra e veprimtarisë së entitetit përfshirë organizimin e tij dhe veçoritë e pronësisë.
 - Diversiteti dhe kompleksiteti i operacioneve të entitetit.
 - Kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme.
 - Rrethanat dhe elementi përbërës i zbatueshëm i kontrollit të brendshëm.
 - Natyra dhe kompleksiteti i sistemeve që bëjnë pjesë në kontrollin e brendshëm të entitetit, përfshirë përdorimin e organizatave të shërbimit.
 - Nëse dhe si një kontroll i caktuar, individual ose i kombinuar me të tjerë, parandalon, zbulon dhe korrigjon, anomalinë materiale.
- A70. Kontrollet e bëra mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të përgatitur nga entiteti mund të jenë gjithashtu të përshtatshme për auditimin, në qoftë se audituesi synon ta përdorë informacionin për planifikimin dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme. Kontrollet në lidhje me operacionet dhe pajtueshmërinë me objektivat mund të jenë të rëndësishëm për auditimin, në qoftë se ato kanë të bëjnë me të dhënat që audituesi i vlerëson dhe i përdor gjatë zbatimit të procedurave të auditimit.
- A71. Kontrolli i brendshëm për ruajtjen e aktiveve kundrejt përvetësimeve, përdorimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit në mënyrë të paautorizuar, mund të përfshijë kontrollet si në lidhje me raportimin financiar ashtu dhe objektivat e funksionimit. Vëmendja e audituesit në lidhje me kontrolle të tillë, kufizohet në përgjithësi në

ato kontrolle, të cilët janë të rëndësishëm për sa i përket besueshmërisë së raportimit financiar.

- A72. Në përgjithësi, një entitet kryen kontrolle në lidhje me objektivat, por nuk është e thënë që këto kontrolle të jenë të rëndësishme për auditimin, ndaj mund të mos merren parasysh. Për shembull, një entitet mund të përdorë një sistem të sofistikuar kontrollesh të automatizuara për të patur efektivitet dhe efikasitet në veprimtarinë e tij (siç është sistemi i kontrolleve të automatizuara në linjat tregtare ajrore për mbajtjen në rregull të grafikut të fluturimeve), por këto lloj kontrollesh zakonisht nuk janë të rëndësishme për auditimin. Për më tepër, edhe pse kontrollet e brendshëm zbatohen në të gjithë entitetin apo në çdo njësi operative dhe procesi biznesi, njohja e kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me çdo njësi dhe proces mund të mos jetë gjithashtu e rëndësishme për auditimin.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

- A73. Audituesit e sektorit publik shpesh kanë përgjegjësi shtesë në lidhje me kontrollin e brendshëm si për shembull, të raportojnë në lidhje me pajtueshmërinë me një kod të praktikës. Gjithashtu ata mund të kenë përgjegjësi që të raportojnë për pajtueshmërinë me ligjin, rregulloret ose autoritet tjetër. Si rezultat, rishikimi i tyre lidhur me kontrollin e brendshëm mund të jetë më i gjerë dhe më i detajuar.

Natyra dhe Shtrirja e Njohjes të Kontrolleve të Përshtatshme (Ref:Para.13)

- A74. Vlerësimi i mënyrës sesi është hartuar një kontroll nënkupton shqyrtimin nëse kontrolli, më vete ose i kombinuar me kontrolle të tjerë, është në gjendje të parandalojë, ose të zbulojë dhe të korrigjojë, në mënyrë efektive anomalitë materiale. Zbatimi i një kontrolli do të thotë që kontrolli ekziston dhe që entiteti e përdor atë. Vlerësimi i zbatimit të një kontrolli që nuk është efektiv e ndihmon shumë pak audituesin në vlerësimin e tij, prandaj mënyra sesi është hartuar kontrolli është ajo që shqyrtohet e para. Një kontroll që nuk është hartuar si duhet përbën një mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm.

- A75. Procedurat e vlerësimit të rrezikut që shërbejnë për të marrë evidencën e auditimit lidhur me hartimin dhe zbatimin e kontrolleve përkatëse mund të përfshijnë:

- Bisedat me personelin e entitetit.
- Vëzhgimin e zbatimit të kontrolleve specifike.
- Inspektimin e dokumentave dhe raporteve.
- Gjurmimin e transaksioneve nëpërmjet sistemit të informacionit që ka të bëjë me raportimin financiar.

Megjithatë, vetëm marrja e informacionit nuk është mjaftueshëm për qëllime të tilla.

A76. Njohja e kontrolleve të entitetit nuk mjafton për të shërbyer si testim mbi efektshmërinë e operimit të kontrolleve po qe se nuk ka një shkallë automatizimi, e cila të sigurojë zbatimin e vijueshëm të operacionit të kontrollit. Për shembull, sigurimi i evidencës së auditimit për zbatimin e një kontrolli manual në një moment kohe të dhënë nuk përbën një evidencë auditimi mbi efektivitetin e operimit të kontrollit për një kohë tjetër gjatë periudhës së auditimit. Prandaj, për shkak të koherencës së natyrshme të përpunimit të të dhënave në TI (referoju paragrafit A63), kryerja e procedurave të auditimit për të konstatuar nëse është zbatuar një kontroll i automatizuar, mund të shërbejë si një test i efektivitetit të operimit të kontrollit, në varësi të vlerësimit dhe testimit nga ana e audituesit të kontrolleve të tilla si ato për ndryshimet e programit. Testet e efektivitetit të zbatimit të kontrolleve janë shpjegur më tej në SNA 330.¹³

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm –Mjedisi i Kontrollit (Ref: Para. 14)

A77. Mjedisi i kontrollit përfshin të gjithë funksionet e qeverisjes dhe të drejtimit si edhe sjelljet, vetëdijen dhe veprimet e individëve që kanë role qeverisëse e të drejtimit, të cilat kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe rëndësinë e tij për entitetin. Mjedisi i kontrollit përcakton tonin e veprimeve të një organizate dhe influencon në ndërgjegjësimin e njerëzve.

A78. Elementë të mjedisit të kontrollit që duhen patur parasysh gjatë njohjes së mjedisit të kontrollit përfshijnë sa më poshtë:

- (a) *Komunikimi dhe vënia në jetë e integritetit dhe vlerave etike* – Këta janë elementë thelbësore që ndikojnë në efektivitetin e projektimit, administrimit dhe vëzhgimit të kontrolleve.
- (b) *Angazhimi për të vepruar me kompetencë* – Çështje të tilla si vlerësimet që bën drejtimi lidhur me nivelet e nevojshme të kompetencës që duhen për kryerjen e detyrave të veçanta dhe mënyra se si këto nivele konvertohen në kërkesa për zotësi dhe njohuri praktike të nevojshme.
- (c) *Pjesëmarrja dhe roli që luajnë personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit* –Karakteristikat e personave të ngarkuar me qeverisjen siç janë:
 - Pavarësia e tyre nga drejtimi.
 - Eksperienca dhe profesionalizmi i tyre.

¹³SNA330,Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Shkalla e tyre e impenjimit dhe informacioni që ata marrin si dhe mbikëqyrja e aktiviteteve.
 - Përshtatshmëria e veprimeve të tyre, ku përfshihen niveli i ngritjes dhe ndjekjes së çështjeve të vështira me drejtimin si dhe bashkërendimi i punës me audituesit e brendshëm dhe të jashtëm.
- (d) *Filozofia dhe stili i operimit të drejtimit* – Karakteristika të drejtimit siç janë:
- Metoda që përdor drejtimi për të ndërmarrë dhe administruar rreziqet e veprimtarisë.
 - Qëndrimet dhe veprimet e tij ndaj raportimit financiar.
 - Qëndrimet e tij ndaj përpunimit të informacionit, funksioneve të kontabilitetit dhe personelit.
- (e) *Struktura organizative*–Kuai brenda të cilit planifikohen, kryhen, kontrollohen dhe rishikohen aktivitetet e entitetit në funksion të arritjes së objektivave të tij.
- (f) *Dhënia e autoritetit dhe përgjegjësisë* –Çështje të tilla si mënyra e caktimit të autoritetit dhe përgjegjësisë për aktivitetet operative si dhe mënyra si është vendosur hierarkia midis marrëdhënieve të raportimit e autorizimit.
- (g) *Politikat dhe praktikrat në lidhje me burimet njerëzore*–Politikat dhe praktikrat që kanë lidhje me për shembull, rekrutimin, orientimin, kualifikimin, vlerësimin, këshillimin, promovimin, shpërblimin dhe korrigjimin e gabimeve.

Evidenca e Auditimit për Elementët e Mjedisit të Kontrollit

- A79. Evidencë auditimi e përshtatshme mund të sigurohet duke kombinuar kërkesat për informacion me procedurat e tjera të vlerësimit të rrezikut, për shembull, duke bërë konfirmimin midis kërkesave për informacion me vëzhgimin ose inspektimin e dokumentave. Për shembull, nëpërmjet kërkesave për marrjen e informacioneve nga drejtimi dhe punonjësit, audituesi arrin të kuptojë mënyrën që përdor drejtimi për t'u komunikuar punonjësve pikëpamjet e tij për praktikrat e biznesit dhe sjelljen etike. Audituesi nxjerr konkluzione në se entiteti i zbaton ose jo kontrollet, duke u nisur nga fakti për shembull, që drejtimi i entitetit ka vendosur një kod formal të sjelljes dhe nga fakti në se ai (drejtimi) e respekton këtë kod.
- A80. Gjithashtu, audituesi mund të marrë në konsideratë mënyrën se si drejtimi ka reaguar ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të funksionit të auditimit të brendshëm lidhur me mangësitë e identifikuara në kontrollin e brendshëm që kanë të bëjnë me

auditimin, duke përfshirë faktin nëse dhe në ç`mënyrë janë zbatuar këto reagime, dhe nëse ato janë vlerësuar më pas nga funksioni i auditimit të brendshëm.

Ndikimi i Mjedisit të Kontrollit në Vlerësimin e Rreziqeve të Anomalisë Materiale

A81. Disa elementë të mjedisit të kontrollit të entitetit kanë një ndikim depërtues në vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale. Për shembull, ndërgjegjja e kontrollit në një entitet influencohet në mënyrë të ndjeshme nga personat e ngarkuar me qeverisjen, duke qënë se një nga rolet kryesore të tyre është që të kundër-balancojnë presionet që i bëhen drejtimit në lidhje me raportimin financiar, të cilat mund të lindin nga kërkesat e tregut ose skemat e shpërblimeve. Efektiviteti i mënyrës sesi është krijuar mjedisi i kontrollit për sa i përket pjesëmarrjes në të të personave të ngarkuar me qeverisjen ndikohet për pasojë nga çështje të tilla si:

- Pavarësia nga drejtimi dhe aftësia e tyre për të vlerësuar veprimet e drejtimit.
- Fakti nëse ata njohin dhe kuptojnë transaksionet e biznesit të entitetit.
- Shkalla në të cilën ata vlerësojnë faktin nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

A82. Një bord drejtorësh aktiv dhe i pavarur mund të ndikojë në filozofinë dhe stilin e operimit të drejtimit të lartë. Megjithatë, elementë të tjerë mund të kenë një ndikim më të kufizuar. Për shembull, edhe pse politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore të orientuara drejt punësimit të personave të aftë në fushën e financës, kontabilitetit dhe TI mund të zvogëlojnë rrezikun e gabimeve në përpunimin e informacionit financiar, ato nuk mund të zbusin paragjykimin e fortë të drejtimit të lartë për të rritur fitimet.

A83. Ekzistenca e një mjedisi kontrolli të kënaqshëm mund të jetë një faktor pozitiv për audituesin, kur ai vlerëson rreziqet e anomalisë material. Sidoqoftë, megjithëse mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të mashtrimit, një mjedisi i kënaqshëm kontrolli nuk e parandalon mashtrimin në mënyrë absolute. Në të kundërt, mangësitë në mjedisin e kontrollit mund të dobësojnë efektivitetin e kontroleve, veçanërisht në lidhje me mashtrimin. Për shembull, dështimi i drejtimit në sigurimin e burimeve të mjaftueshme për trajtimin e rreziqeve të sigurisë të TI mund të ketë ndikim negativ në kontrollin e brendshëm duke lejuar ndryshimet e pasakta në programet ose të dhënat kompjuterike, ose përpunimin e transaksioneve të paautorizuara. Sic është shpjeguar në SNA 330, mjedisi i kontrollit influencon gjithashtu natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit.¹⁴

A84. Mjedisi i kontrollit në vetvete nuk parandalon, zbulon apo korrigjon një anomali

¹⁴SNA330,paragrafëtA2–A3.

materiale. Megjithatë, ai mund të ndikojë në vlerësimin e audituesit për efektivitetin e kontrolleve të tjerë (për shembull, vëzhgimin e kontrolleve dhe funksionimin e aktiviteteve të caktuara të kontrollit) dhe në këtë mënyrë, vlerësimin e audituesit për rreziqet e anomalisë materiale.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

- A85. Mjedisi i kontrollit në entitetet e vogla ka gjasa të ndryshojë nga ai në entitetet e mëdha. Për shembull, personat e ngarkuar me qeverisjen në entitetet e vogla mund të mos përfshijnë një anëtar të pavarur dhe të jashtëm, dhe roli i qeverisjes mund të ndërmerret direkt nga pronari-drejtues në rastet kur nuk ka pronarë të tjerë. Natyra e mjedisit të kontrollit mund të ndikojë gjithashtu rëndësinë e kontrolleve të tjerë, ose mungesën e tyre. Për shembull, përfshirja aktive e një pronari-drejtues mund të eliminojë disa nga rreziqet që lindin nga mungesa e ndarjes së detyrave në një entitet të vogël; por ajo mundet gjithashtu të shtojë rreziqe të tjerë, si për shembull, rreziku i refuzimit të kontrolleve.
- A86. Përveç kësaj, evidenca e auditimit për elementët e mjedisit të kontrollit në entitetet e vogla mund të mos jetë në formën e një dokumenti, veçanërisht në ato raste kur komunikimi ndërmjet drejtimit dhe personelit tjetër është jo formal, por gjithsesi i vlefshëm. Për shembull entitetet e vogla mund të mos kenë një kod sjelljeje të shkruar, por në vend të tij kanë zhvilluar një kulturë e cila vë theksin tek rëndësia e integritetit dhe sjelljes etike nëpërmjet komunikimit verbal dhe shembullit të dhënë nga ana e drejtimit.
- A87. Për pasojë, qëndrimet, ndërgjegjësimi dhe veprimet e drejtimit ose të pronarit-drejtues kanë një rëndësi të veçantë në njohjen nga ana e audituesit të mjedisit të kontrollit të entitetit të vogël.

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm – Procesi i Vlerësimit të Rrezikut të Entitetit (Ref: Para. 15)

- A88. Procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit përbën bazën mbi të cilën drejtimi përcakton mënyrën e menaxhimit të rreziqeve. Në qoftë se ky proces është i përshtatshëm për rrethanat, ku përfshihen natyra, madhësia dhe kompleksiteti i entitetit, kjo gjë e ndihmon audituesin për identifikimin e rreziqeve të anomalisë materiale. Fakti nëse procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit është i përshtatshëm për rrethanat apo jo është çështje e gjykimit të audituesit.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla (Ref: Para.17)

- A89. Ka shumë pak gjasa që entitetet e vogla të kenë vendosur një proces të vlerësimit të rrezikut. Në raste të tilla, mundet që drejtimi të identifikojë rreziqet nëpërmjet përfshirjes së tij direkte në biznes. Megjithatë, pavarësisht rrethanave, është e nevojshme që audituesi të kërkojë informacion lidhur me rreziqet e identifikuar

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

dhe mënyrën sesi ato janë trajtuar nga drejtimi i entitetit të vogël.

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm – Sistemi i Informacionit Përfshirë Proceset Përkatëse të Veprimtarisë, që Lidhen me Raportimin Financiar dhe Komunikimin

Sistemi i Informacionit Përfshirë Proceset Përkatëse të Veprimtarisë që Lidhen me Raportimin Financiar (Ref:Para. 18)

A90. Sistemi i informacionit që lidhet me objektivat e raportimit financiar, i cili e përfshin sistemin kontabël, konsiston në procedurat dhe regjistrat e hartuar dhe vendosur për të:

- Filluar, regjistruar, përpunuar dhe raportuar transaksionet e entitetit (si edhe ngjarjet dhe kushtet) dhe për të garantuar përgjegjshmërinë për aktivet, detyrimet dhe kapitalin.
- Ndrequr problemet që lindin nga përpunimi i gabuar i transaksioneve, për shembull, procedurat që pezullojnë në mënyrë automatike të cilat zbatohen për të korrigjuar apo zgjidhur në kohë elementët e pezulluar;
- Përpunuar dhe trajtuar anashkalimet apo shmangiet që sistemi u bën kontrolleve;
- Transferuar informacionin nga sistemet e përpunimit të transaksionit në librin e madh;
- Siguruar informacion në lidhje me raportimin financiar për ngjarjet dhe kushtet, përveç transaksioneve, si për zhvlerësimin dhe amortizimin e mjeteve ashtu dhe për ndryshimet në mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme; dhe
- Siguruar që informacioni i kërkuar për tu deklaruar sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, është mbledhur, regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare.

A.91. Pasqyrat financiare mund të përmbajnë informacione që merren nga jashtë librit të madh dhe atyre ndihmës. Shembuj të këtyre informacioneve janë:

- Informacioni i marrë nga marrëveshjet e qirasë, i dhënë në pasqyrat financiare, siç janë opsionet e rinovimit ose pagesa të ardhshme të qirasë.
- Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare që merret nga sistemi i administrimit të rrezikut të një entiteti.
- Informacionet mbi vlerën e drejtë të përgatitur nga ekspertët e drejtimit dhe të paraqitur në pasqyrat financiare.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare që është marrë nga modelet, ose nga llogaritjet e tjera të përdorura për kryerjen e çmuarjeve, të njohura ose të paraqitura në pasqyrat financiare, përfshirë informacionet në lidhje me datën e vlerësimit dhe supozimet e përdorura në ato modele, të tilla si:
 - Supozime të zhvilluara së brendshmi që mund të ndikojnë në jetën e dobishme të një aktivi; ose
 - Të dhëna të tilla si normat e interesit që ndikohen nga faktorë jashtë kontrollit të entitetit.
- Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare në lidhje me analizat e ndjeshmërisë të përfituara nga modelet financiare të cilat tregojnë se drejtimi ka bërë supozime alternative.
- Informacioni i njohur ose i paraqitur në pasqyrat financiare që është marrë nga deklaratat dhe regjistrimet tatimore të një entiteti.
- Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare që është marrë nga analizat e përgatitura për të mbështetur vlerësimin e drejtimit për vijimësinë e entitetit, siç janë të dhënat, nëse ka, në lidhje me ngjarje ose kushte që janë identifikuar, të cilat mund të hedhin dyshime të konsiderueshme lidhur me vijimësinë e entitetit.¹⁵

A92. Njohja e sistemit të informacionit që lidhet me raportimin financiar, të kërkuar nga paragrafi 18 i kësaj SNA-je (përfshirë njohjen e aspekteve përkatëse të këtij sistemi në lidhje me informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare që janë marrë nga brenda ose jashtë librit të madh dhe atyre ndihmës) është një çështje e gjykimit profesional të audituesit. Për shembull, disa shuma ose informacione shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të entitetit (siç janë informacionet shpjeguese në lidhje me rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut) mund të bazohen në informacionin e marrë nga sistemi i administrimit të rrezikut të entitetit. Sidoqoftë, audituesit nuk i kërkohet të njohë të gjitha aspektet e sistemit të administrimit të rrezikut, por të përdorë gjykimin profesional në përcaktimin e njohjes së nevojshme.

Artikujt Kontabël (regjistrimet në ditar)

A93. Sistemi i informacionit i një entiteti, në mënyrë tipike, përfshin artikujt kontabël standard që përdoren për të regjistruar transaksionet në mënyrë periodike. Shembuj të tillë mund të jenë artikujt kontabël për të regjistruar shitjet, blerjet dhe arkëtimet e parasë në librin e madh, ose për të regjistruar çmuarjet kontabël që bëhen periodikisht nga drejtimi, siç janë ndryshimet në çmuarjen e llogarive të arkëtueshme të

¹⁵ Shiko paragrafët 19-20 të SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*.

pambledhshme.

A94. Procesi i raportimit financiar të një entiteti përfshin gjithashtu përdorimin e artikujve kontabël jostandard për të regjistruar transaksionet e pazakonta, joperiodike ose regjistrimet rregulluese. Shembujt të artikujve të tillë përfshijnë konsolidimin e regjistrimeve rregulluese dhe artikujve kontabël në një kombinim ose shitje biznesi, ose çmuarjet joperiodike siç mund të jetë zhvlerësimi i një aktivi. Në sistemet manuale të librit të madh, artikujt jostandard të ditarit mund të identifikohen nëpërmjet inspektimit të librave, ditarëve dhe dokumentacionit mbështetës. Në rastet kur për të mbajtur librin e madh dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, përdoren procedurat e automatizuara, të tillë artikuj ekzistojnë vetëm në formën elektronike dhe mund të jenë më të lehtë për t'u identifikuar nëpërmjet përdorimit të teknikave të auditimit me ndihmën e kompjuterit.

Proceset Përkatese të Veprimtarisë (Ref: Para.18)

A95. Procese të veprimtarisë së një entiteti janë veprimtaritë që kanë për qëllim të:

- Zhvillojnë, blejnë, prodhojnë, shesin dhe shpërndajnë produktet dhe shërbimet e tij;
- Sigurojnë respektimin e ligjeve dhe rregullave; dhe
- Regjistrojnë informacionin, përfshirë edhe informacionin e raportimit financiar e kontabël.

Proceset e veprimtarisë rezultojnë në transaksione të cilat regjistrohen, përpunohen dhe raportohen nga sistemi i informacionit. Njohja e proceseve të veprimtarisë së entitetit, që përfshin mënyrën sesi janë krijuar transaksionet, e ndihmon audituesin në njohjen e sistemit të informacionit që ka të bëjë me raportimin financiar në një mënyrë që është e përshtatshme për rrethanat e entitetit.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla (Ref: Para.18)

A96. Sistemet e informacionit dhe proceset përkatëse të veprimtarisë që lidhen me raportimin financiar në entitetet e vogla, përfshirë aspektet përkatëse të këtij sistemi në lidhje me informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare që merret nga brenda ose jashtë librit të madh dhe librave ndihmës, ka të ngjarë të të jenë më pak të sofistikuar se në entitetet e mëdha, por roli i tyre është njëlloj i rëndësishëm. Entitetet e vogla me përfshirje aktive të drejtimit mund të mos kenë nevojë për përshkrime të zgjeruara të procedurave kontabël, për regjistrime kontabël të sofistikuar, ose politika të shkruara. Prandaj njohja e sistemeve të entitetit është më e lehtë në entitetet e vogla, dhe mund të jetë më shumë e lidhur me kërkimin e informacionit sesa me rishikimin e dokumentave. Gjithsesi, nevoja për të njohur

proceset e veprimtarisë së entitetit mbetet e rëndësishme.

Komunikimi (Ref: Para, 19)

A97. Komunikimi nga ana e entitetit i roleve dhe përgjegjësiëve të raportimit financiar dhe çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me raportimin financiar përfshin njohjen e roleve dhe të përgjegjësiëve individuale që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm në raportimin financiar. Ai përfshin çështje të tilla si shpjegimi apo instruksionet që i jepen personelit me qëllim që ai të kuptojë mënyrën se si lidhen veprimtaritë e tij në sistemin e informacionit e të raportimit financiar me veprimtaritë që kryejnë individët e tjerë dhe mënyrat sipas të cilave realizohen raportimet e rasteve përjashtimore tek personat e niveleve të larta brenda entitetit. Komunikimi mund të marrë forma të tilla siç janë manualët e politikave dhe manualët e raportimit financiar. Kanalet e hapura të komunikimit ndihmojnë në dhënien e sigurisë që rastet përjashtimore janë raportuar dhe që janë marrë masa lidhur me to.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A98. Komunikimi mund të jetë më pak i strukturuar dhe më i lehtë për t'u arritur në një entitet të vogël se sa në një entitet të madh, për shkak të ekzistencës të më pak niveleve të përgjegjësisë, si edhe për dukshmërinë dhe disponueshmërinë më të madhe të drejtimit.

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm — Aktivitetet e Kontrollit të rëndësishëm për Auditimin(Ref: Para. 20)

A99. Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat që ndihmojnë për t'u siguruar se janë zbatuar direktivat e drejtimit. Aktivitetet e kontrollit, si në formën e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) apo të sistemeve manuale, kanë disa objektiva dhe aplikohen në nivele të ndryshme organizative dhe funksionale. Shembuj të aktiviteteve të veçanta të kontrollit përfshijnë:

- Autorizimin.
- Rishikimin e performancës.
- Përpunimin e informacionit.
- Kontrollat fizike.
- Ndarjen e detyrave.

A100. Aktivitetet e kontrollit të rëndësishme për qëllime të auditimit janë:

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Ato që kërkohet të trajtohen si të tillë, duke qënë se janë aktivitete që kanë të bëjnë me rreziqe të rëndësishme dhe ato që kanë të bëjnë me rreziqe për të cilat kryerja vetëm e procedurave thelbësore nuk jep evidencën e nevojshme të auditimit, siç kërkohet nga paragrafët 29 dhe 30, respektivisht; ose
- Ato që konsiderohen që janë të rëndësishme sipas gjykimit të audituesit.

- A101. Gjykimi i audituesit për faktin nëse një aktivitet kontrolli është i përshtatshëm për qëllime të auditimit influencohet nga rreziku që audituesi ka identifikuar i cili mund të bëhet shkas për një anomali materiale dhe nëse audituesi mendon që ka gjasa që të jetë e përshtatshme të testojë efektivitetin operativ të kontrollit në lidhje me përcaktimin e shtrirjes së testimit thelbësor
- A102. Theksi i audituesit duhet të vihet në identifikimin dhe në kuptimin e atyre aktiviteteve të kontrollit që trajtojnë aspekte, për të cilat audituesi mendon se rreziku i anomalisë materiale ka të ngjarë të jetë i lartë. Kur aktivitetet e kontrollit shumëfishe arrijnë secila të njëjtin objektiv, nuk është e nevojshme që të sigurohet njohje për secilin aktivitet kontrolli që lidhet me këtë objektiv.
- A103. Aktivitetet e kontrollit që kanë të bëjnë me auditimin mund të përfshijnë kontrollet e krijuara nga drejtimi që trajtojnë rreziqet e anomalisë materiale në lidhje me informacionet shpjeguese të dhëna, që nuk përgatiten në pajtueshmëri me kuadrin në fuqi të raportimit financiar, përveç kontrolleve që adresojnë rreziqet që lidhen me tepricat e llogarive dhe transaksioneve. Keto aktivitete kontrolli mund të lidhen me informacionin e përfshirë në pasqyrat financiare që është marrë nga libri i madh dhe librat ndihmës.
- A104. Njohuritë e audituesit rreth prezencës apo mungesës së aktiviteteve të kontrollit, të cilat janë siguruar nga njohja dhe kuptimi i komponentëve të tjera të kontrollit të brendshëm, e ndihmojnë audituesin për të përcaktuar nëse njohjes së aktiviteteve të kontrollit duhet t'i kushtohet një vëmendje shtesë.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

- A105. Konceptet mbi të cilat bazohen aktivitetet e kontrollit në entitetet e vogla ka të ngjarë të jenë të ngjashme me ato në entitetet e mëdha, por niveli i formalitetit me të cilin ato operojnë mund të ndryshojë. Për më tepër, entitetet e vogla mund të mos e konsiderojnë të nevojshme zbatimin e disa llojeve të caktuara të aktiviteteve të kontrollit për arsye të kontrolleve të zbatuara nga drejtimi. Për shembull, fakti që vetëm drejtimi ka të drejtën për t'ju dhënë kredi klientëve dhe për të aprovuar blerje të rëndësishme përbën një kontroll të fortë mbi gjëndjet e llogarisë dhe transaksionet e rëndësishme, duke pakësuar ose eliminuar nevojën për aktivitete kontrolli më të detajuara.
- A106. Aktivitetet e kontrollit të përshtatshme për qëllime të auditimit të entiteteve të vogla ka

të ngjarë që të kenë të bëjnë me ciklet kryesore të transkacioneve sic janë të ardhurat, blerjet dhe shpenzimet e punonjësve.

Rreziqet që Burojnë nga Sistemi TI (Ref: Para. 21)

A107. Përdorimi i sistemit TI ndikon në mënyrën se si janë zbatuar aktivitetet e kontrollit. Sipas këndvështrimit të audituesit, kontrollet ndaj sistemeve TI janë efektive kur ata ruajnë vërtetësinë e informacionit dhe sigurinë e të dhënave që sisteme të tillë përpunojnë, duke përfshirë kontrolle të përgjithshme të TI dhe kontrolle të zbatimit.

A108. Kontrollet e përgjithshme të sistemeve TI janë politikat dhe procedurat që lidhen me shumë aplikacione dhe mbështetin funksionimin me efektivitet të kontrolleve aplikative. Ato zbatohen në mainframe, miniframe, dhe mjediset e përdoruesve fundorë. Kontrollet e përgjithshme të sistemeve TI, që garantojnë integritetin e informacionit dhe sigurinë e të dhënave, zakonisht përfshijnë kontrollet mbi:

- Qëndrat e të dhënave dhe operacionet në rrjet.
- Blerjen e sistemeve të programeve kompjuterike (software), ndryshimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Ndryshimin e programit.
- Sigurinë për hyrjen në të dhëna.
- Blerjen e sistemeve të programeve aplikative, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Përgjithësisht ato zbatohen për të trajtuar rreziqet që janë referuar në paragrafin A64 më sipër.

A109. Kontrollet aplikative janë procedura manuale ose automatike që operojnë kryesisht në nivelin e përpunimit të biznesit dhe që zbatohen në përpunimin e transaksioneve nga aplikacionet individuale. Kontrollet aplikative mund të kenë natyrë ndaluese ose zbuluese, dhe synojnë të sigurojnë integritetin e regjistrimeve kontabël. Rrjedhimisht, kontrollet aplikative lidhen me procedurat që kanë të bëjnë me iniciimin, regjistrimin, përpunimin dhe raportimin e transaksioneve ose të të dhënave të tjera financiare. Këto kontrolle ndihmojnë për të garantuar që transaksionet që kanë ndodhur janë të autorizuar, dhe se ato janë regjistruar e përpunuar plotësisht e saktësisht. Si shembuj mund të përmenden pasqyrimi në ekran i disa kontrolleve të hedhjes së të dhënave, kontrolli i serive numerike krahasuar me kontrollet manuale si dhe me raportet përjashtuese apo të korrigjimit në pikat e hyrjes së të dhënave.

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm—Vëzhgimi i Kontrolleve(Ref: Para.22)

A110. Vëzhgimi i kontrolleve është procesi i vlerësimit të efektivitetit të performancës së kontrollit të brendshëm gjatë periudhave të ndryshme kohore. Ai përfshin vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve gjatë periudhave dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme korrigjuese. Drejtuesit kryejnë vëzhgimin e kontrolleve gjatë veprimtarive të tyre të përditëshme, me vlerësime të veçanta, ose nëpërmjet një kombinimi të tyre. Aktivitetet e vëzhgimit të vazhdueshëm shpesh janë ndërtuar mbi bazën e aktivitetit të zakonshëm e të përsëritur të entitetit dhe përfshijnë aktivitetet e rregullta të menaxhimit dhe të mbikëqyrjes. A111. Aktivitetet e vëzhgimit të kryera nga drejtimi mund të përfshijnë përdorimin e informacionit që merret nëpërmjet komunikimit me të tretët, siç janë: ankesat nga konsumatorët dhe komentet nga rregullatorët, të cilat mund të paraqesin problemet, ose të nxjerrin në pah aspektet që duhen përmirësuar.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A112. Vëzhgimi i kontrolleve nga ana e drejtimit zakonisht kryhet nëpërmjet përfshirjes së ngushtë të drejtimit ose të pronarit-drejtues në operacionet e entitetit. Kjo përfshirje shpesh do të shërbejë për të identifikuar shmangiet e mëdha krahasuar me parashikimet dhe pasaktësitë në të dhënat financiare të cilat çojnë në veprime korrigjuese të kontrollit.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm të Entitetit (Ref: Para. 23)

A113. Nëse entiteti ka një funksion të auditimit të brendshëm, njohja nga audituesi i këtij funksioni kontribuon në njohjen e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm dhe në veçanti rolin që ky funksion luan në vëzhgimin e kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar të entitetit. Kjo njohje, së bashku me informacionin e marrë nga kërkimet e audituesit për informacion sipas paragrafit 6 (a) të kësaj SNA-je, mundet gjithashtu, të japin informacione që lidhen drejtpërdrejtë me identifikimin dhe vlerësimin e audituesit për rreziqet e anomalisë materiale.

A114. Objektivat dhe qëllimi i funksionit të auditimit të brendshëm, natyra e përgjegjësiave dhe statusi i tij brenda organizatës, përfshirë autoritetin dhe përgjegjësinë e funksionit, ndryshojnë gjerësisht dhe varen nga madhësia dhe struktura e entitetit dhe kërkesat e drejtimit, dhe ku është e zbatueshme, nga kërkesat e personave të ngarkuar me qeverisjen. Këto çështje mund të përfshihen në një kartë të auditimit të brendshëm ose në termat e referencës.

A115. Përgjegjësitë e një funksioni të auditimit të brendshëm mund të përfshijnë kryerjen e procedurave dhe vlerësimin e rezultateve për të dhënë siguri për drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, në lidhje me dizajnin dhe efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm dhe proceseve të qeverisjes.

Nëse është kështu, funksioni i auditimit të brendshëm mund të luajë një rol të rëndësishëm në monitorimin e kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar të entitetit. Sidoqoftë, përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm mund të përqendrohen në vlerësimin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të operacioneve dhe, nëse është kështu, puna e funksionit mund të mos lidhet drejtpërdrejt me raportimin financiar të entitetit.

- A116. Kërkesat për informacion tek individët e duhur brenda funksionit të auditimit të brendshëm, në përputhje me paragrafin 6 (a) të kësaj SNA-je, ndihmojnë audituesin të njohë natyrën e përgjegjësiave të funksionit të auditimit të brendshëm. Nëse audituesi përcakton se përgjegjësitë e funksionit kanë të bëjnë me raportimin financiar të entitetit, ai mund të marrë njohuri të mëtejshme të aktiviteteve të kryera ose që do të kryhen, nga funksioni i auditimit të brendshëm, duke rishikuar planin e auditimit të funksionit të auditimit të brendshëm për periudhën, nëse ka, dhe duke e diskutuar në lidhje me këtë plan me individët e duhur brenda këtij funksioni.
- A117. Nëse natyra e përgjegjësiave të funksionit të auditimit të brendshëm dhe e aktiviteteve të dhënies së sigurisë lidhen me raportimin financiar të entitetit, audituesi mund të jetë në gjendje të përdorë punën e funksionit të auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose afatet, ose zvogëluar shtrirjen e procedurave të auditimit, që kryhen drejtpërdrejt nga ai në marrjen e evidencës së auditimit. Audituesit kanë më shumë të ngjarë të jenë në gjendje të përdorin punën e funksionit të auditimit të brendshëm të një entiteti kur, për shembull, bazuar në përvojën në auditimeve të mëparshme, ose në procedurat e audituesit të vlerësimit të rrezikut, konstatohet se entiteti ka një funksion të auditimit të brendshëm me burimet e duhura në raport me madhësinë e entitetit dhe natyrën e veprimtarive të tij, dhe ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë raportimi me personat e ngarkuar me qeverisjen.
- A118. Nëse, bazuar në njohjen paraprake të audituesit për funksionin e auditimit të brendshëm, audituesi pret që të përdorë punën e funksionit të auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose afatet, ose për të zvogëluar shtrirjen e procedurave të auditimit që duhet të kryhen, ai duhet të zbatojë SNA 610 (Rishikuar në 2013).
- A119. Siç është diskutuar më tej në SNA 610 (Rishikuar në 2013), aktivitetet e një funksioni të auditimit të brendshëm janë të dallueshme nga kontrollet e tjera të monitorimit që mund të jenë të lidhura me raportimin financiar, siç janë rishikimet e informacionit të kontabilitetit të drejtimit që janë dizenuar për të kontribuar në mënyrën se si entiteti parandalon ose zbulon anomalitë.
- A120. Vendosija e komunikimeve me individët e duhur brenda funksionit të auditimit të brendshëm të një entiteti herët në fillim të angazhimit, dhe mbajtja e komunikimeve të tilla gjatë gjithë angazhimit, mund të lehtësojë shkëmbimin efektiv të informacionit. Kjo krijon një mjedis në të cilin audituesi mund të

informohet për çështje të rëndësishme që mund të vijnë në vëmendjen e funksionit të auditimit të brendshëm, kur çështje të tilla mund të ndikojnë në punën e audituesit. SNA 200 trajton rëndësinë e planifikimit të auditimit dhe kryerjen e tij me skepticizëm profesional, përfshirë të qenurit vigjilent ndaj informacionit që sjell dyshime mbi besueshmërinë e dokumenteve dhe te përgjigjeve të pyetjeve të cilat do të përdoren si evidence auditimi. Prandaj, komunikimi me funksionin e auditimit të brendshëm gjatë gjithë angazhimit mund të japë mundësi për audituesit e brendshëm që ata të sjellin në vëmendjen e audituesit këto informacione. Më pas audituesi është në gjendje që këto informacione t'i mbajë parasysht gjatë identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të anomalisë materiale.

Burimet e Informacionit (Ref: Para. 24)

A121. Pjesa më e madhe e informacionit të përdorur gjatë vëzhgimit të kontrolleve sigurohet nga sistemi i informacionit të entitetit. Nëse drejtimi supozon se të dhënat e përdorura për vëzhgim janë të sakta pa patur një bazë për këtë supozim, gabimet që mund të ekzistojnë në informacion mund të bëjnë që drejtimi të dalë me konkluzione të gabuara nga aktivitetet e tij të vëzhgimit. Gjithashtu, njohja e:

- Burimeve të informacionit që kanë të bëjnë me aktivitetet e vëzhgimit të entitetit; dhe
- Bazës mbi të cilën drejtimi mbështet faktin që niveli i besueshmërisë së informacionit të përdorur për këtë qëllim është i mjaftueshëm, kërkohet si pjesë e njohjes nga ana e audituesit të aktiviteteve të kontrollit të entitetit duke qënë se janë pjesë përbërëse e kontrollit të brendshëm.

Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomaliave Materiale

Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale në Nivel të Pasqyrave Financiare
(Ref: Para. 25(a))

A122. Rreziqet e anomalisë materiale në nivel të pasqyrave financiare i referohen rreziqeve që lidhen në mënyrë më të përhapur me pasqyrat financiare në tërësi dhe potencialisht ndikojnë në shumë pohime të tyre. Rreziqe të kësaj natyre nuk janë domosdoshmërisht rreziqe që identifikohen me pohime specifike në nivel të klasës së transaksioneve, tepicës së llogarive, ose informacionit të dhënë. Më saktë, ato përfaqësojnë rrethana që mund të rrisin rreziqet e anomalisë materiale në nivel pohimi, për shembull nëpërmjet refuzimit nga ana e drejtimit të kontrollit të brendshëm. Rreziqet në nivel të pasqyrave financiare janë veçanërisht të lidhura me njohjen e audituesit për rreziqet e anomalisë materiale si pasojë e mashtrimit.

A123. Rreziqet në nivel të pasqyrave financiare mund të shkaktohen në veçanti nga një mjedis kontrolli i mangët (edhe pse rreziqe të tillë mund të lidhen gjithashtu edhe me faktorë të tjerë, siç janë kushtet ekonomike në rënie). Për shembull, mangësi të

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

tilla si mungesa e kompetencës së drejtimit mund të ketë një efekt më të përhapur mbi pasqyrat financiare dhe mund të kërkojë një reagim më të përgjithshëm nga audituesi.

A124. Njohja prej audituesit e kontrollit të brendshëm mund të ngrejë dyshime mbi auditimin e pasqyrave financiare të entitetit. Për shembull:

- Shqetësimet që lidhen me integritetin e drejtimit të entitetit mund të jenë kaq të mëdha sa që ta shtyjnë audituesin të arrijë në përfundimin se ka rrezik që drejtuesit të çorientojnë me pasqyrat financiare dhe për pasojë auditimi mund të mos realizohet.
- Shqetësimet për kushtet dhe besueshmërinë e regjistrimeve të entitetit mund ta çojnë audituesin në konkluzionin se në entitet nuk mund të ekzistojë evidenca e nevojshme, ku të bazohet dhënia e një opinionit pa rezervë mbi pasqyrat financiare.

A125. SNA705 (i rishikuar)¹⁶ vendos kërkesa dhe jep udhëzime në përcaktimin nëse është e nevojshme për audituesin që të shprehë një opinion të kualifikuar ose të refuzojë dhënien e opinionit ose siç mund të kërkohej në disa situata të tërhiqet nga angazhimi, aty ku tërheqja është e mundur sipas ligjit dhe rregullores në fuqi.

Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale në Nivel Pohimi (Ref:Para.25(b))

A126. Rreziqet e anomalisë materiale në nivel pohimi për klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive, dhe informacionet duhet të merren parasysh, sepse ky fakt ndikon drejtpërsëdrejti në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit në nivel pohimi, të nevojshme për të siguruar evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në nivel pohimi, audituesi mund të arrijë në konkluzionin që rreziqet e identifikuar lidhen në mënyrë shumë të përhapur me pasqyrat financiare në tërësi dhe potencialisht ndikojnë në shumë pohime të tyre.

SNA

Përdorimi i Pohimeve

A127. Në paraqitjen e faktit që pasqyrat financiare janë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, drejtimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar bën pohime në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen dhe informacionin e dhënë për klasat e transaksioneve dhe ngjarjeve, tepricat e llogarive dhe shënimet përkatëse.

A128. Audituesi mund të përdorë pohimet siç përshkruhen në paragrafin A129(a) - (b)

¹⁶SNA705 (I rishikuar), *Modifikimet në Opinionin e Raportit të Audituesit të Pavarur*.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

më poshtë ose mund t'i shprehë ato ndryshe, por me kusht që të gjitha aspektet e përshkruara më poshtë të mbulohen. Për shembull, audituesi mund të zgjedhë të kombinojë pohimet në lidhje me klasat e transaksionit dhe ngjarjeve, dhe shënimet përkatëse, me pohimet në lidhje me tepricat e llogarive dhe shënimeve përkatëse.

Pohime lidhur me klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe shënimet përkatëse

A129. Pohimet e përdorura nga audituesi për të patur parasysh tipet e ndryshme të anomalive potenciale që mund të ndodhin përfshihen në një nga kategoritë në vijim:

- (a) Pohime lidhur me klasat e transaksioneve dhe ngjarjet, dhe shënimet përkatëse për periudhën në auditim:
 - (i) Ndodhja—transaksionet dhe ngjarjet që janë regjistruar ose paraqitur në shënimet shpjeguese, kanë ndodhur dhe i përkasin entitetit.
 - (ii) Plotësia—të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhej të ishin regjistruar janë regjistruar, dhe shënimet përkatëse që duhet të përfshihen në pasqyrat financiare, janë përfshirë.
 - (iii) Saktësia—shumat dhe të dhënat e tjera që kanë të bëjnë me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara, janë regjistruar me saktësi, dhe shënimet përkatëse janë matur dhe përshkruar siç duhet.
 - (iv) Paraqitja në periudhën e duhur (Cut-off)— transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e duhur kontabël.
 - (v) Klasifikimi—transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë kontabël të përshtatshme.
 - (vi) Paraqitja—transaksionet dhe ngjarjet janë në mënyrë të përmbledhur ose të detajuar dhe janë përshkruar qartë, dhe shënimet përkatëse janë të përshtatshme dhe të kuptueshme në kontekstin e kërkesave të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.
- (b) Pohime lidhur me tepricat e llogarive, dhe shënimet përkatëse në fund të periudhës:
 - (i) Ekzistenca—aktivet, detyrimet, dhe interesat mbi kapitalin ekzistojnë.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- (ii) Të drejtat dhe detyrimet—entiteti mban dhe kontrollon të drejtat mbi aktivet dhe detyrimet janë obligime të entitetit.
- (iii) Plotësia—të gjitha aktivet, detyrimet dhe interesat mbi kapitalin që duhej të ishin regjistruar janë regjistruar, dhe të gjitha shënimet përkatëse që duhet të jenë përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- (iv) Saktësia, vlerësimi dhe shpërndarja—aktivet, detyrimet, dhe interesat mbi kapitalin janë përfshirë në pasqyrat financiare me vlerat e duhura dhe veprimet rregulluese si rezultat i ndonjë vlerësimi apo shpërndarje, janë regjistruar siç duhet, dhe shënimet përkatëse janë matur dhe përshkruar sic duhet.
- (v) Klasifikimi —aktivet, detyrimet, dhe interesat mbi kapitalin janë regjistruar në llogaritë e duhura.
- (vi) Paraqitja—aktivet, detyrimet, dhe interesat mbi kapitalin janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur ose të detajuar dhe janë përshkruar qartë, dhe shënimet përkatëse janë të përshtatshme dhe të kuptueshme në kontekstin e kërkesave të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.

Pohime lidhur me informacione të tjera shpjeguese të dhëna

A130. Pohimet e përshkruara në paragrafin 129(a) - (b) më lart, përshtatur sipas rastit, mund të përdoren nga audituesi gjithashtu, gjatë marrjes në konsideratë të llojeve të ndryshme të anomalive të mundshme që mund të ndodhin në informacionet shpjeguese të dhëna, që nuk lidhen drejtpërdrejt me klasat e transaksioneve të regjistruara, ngjarjeve, ose tepricat e llogarive. Si shembull i një informacioni të tillë shpjegues të dhënë, entiteti mund t'i kërkohej të përshkruajë ekspozimin e tij ndaj rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare, përfshirë mënyrën e shfaqjes së rreziqeve; objektivat, politikat dhe proceset për menaxhimin e rreziqeve; dhe metodat e përdorura për të matur rreziqet.

Konsidetara të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A131. Në rastin e pohimeve për pasqyrat financiare të sektorit publik, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin A129(a) - (b), drejtimi shpesh mund të bëjë edhe pohime nëse transaksionet dhe ngjarjet janë realizuar në pajtueshmëri me ligjin, rregulloren ose ndonjë autoritet tjetër. Pohime të tilla mund të jenë brenda qëllimit të auditimit të pasqyrave financiare. .

Procesi i Identifikimit të Rreziqeve të Anomalisë Materiale (Ref:Para.26(a))

- A132. Informacionet e mbledhura gjatë kryerjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut, përfshirë evidencën e auditimit të marrë gjatë vlerësimit të dizenjimit dhe funksionimit të kontroleve, përdoret si evidencë auditimi për të mbështetur vlerësimin e rrezikut. Vlerësimi i rrezikut përcakton natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit që duhet të kryhen. Në identifikimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, audituesi ushtron skepticism profesional në përputhje me SNA 200¹⁷.
- A133. Shtojca 2 paraqet shembuj të kushteve dhe ngjarjeve që tregojnë për ekzistencën e rreziqeve të anomalisë materiale, përfshirë rreziqet e anomalisë materiale të shënimeve shpjeguese përkatëse.
- A134. Siç është shpjeguar në SNA 320¹⁸, kur identifikohen dhe vlerësohen rreziqet e anomalive materiale në klasa të transaksioneve, tepricat e llogarive dhe të dhënat përkatëse mbahet parasysh materialiteti dhe rreziku i auditimit. Përcaktimi i audituesit për materialitetin është çështje e gjykimit profesional dhe ndikohet nga perceptimi i audituesit për nevojat për raportim financiar të përdoruesve të pasqyrave financiare.¹⁹
- A135. Gjykimi i audituesit për informacionet e dhëna në pasqyrat financiare kur identifikon rreziqet, përfshin të dhënat sasiore dhe cilësore, anomalitë e të cilave mund të jenë materiale (d.m.th. në përgjithësi, anomalitë konsiderohen të jenë materiale nëse pritet që në mënyrë të arsyeshme ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në pasqyrat financiare në tërësi). Në varësi të rrethanave të entitetit dhe të angazhimit, shembuj të informacioneve të dhëna që do të kenë ndikime cilësore dhe që mund të jenë të rëndësishme kur vlerësoni rreziqet e anomalisë materiale përfshijnë paraqitjet në lidhje me:
- Likuiditetin dhe kontratat e huasë të një entiteti në vështirësi financiare.
 - Ngjarjet ose rrethanat që kanë çuar në njohjen e një humbjeje nga zhvlerësimi.
 - Burimet kryesore të vlerësimit me çmuarje për pasigurinë, përfshirë supozimet për të ardhmen.
 - Natyra e një ndryshimi në politikën kontabël dhe të dhënat e tjera përkatëse të kërkuara nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, si për shembull, kërkesat e reja të raportimit financiar pritet të kenë një ndikim të

¹⁷ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 15

¹⁸ SNA 320, paragrafi A1

¹⁹ SNA 320, paragrafi 4

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQVEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

rëndësishëm në pozicionin financiar dhe performancën financiare të entitetit.

- Marrëveshjet e pagesave të bazuara në aksione, përfshirë informacionin se si janë përcaktuar vlerat e paraqitura, dhe informacionet shpjeguese përkatëse.
- Palët e lidhura dhe transaksionet e palëve të lidhura.
- Analiza e sensibilitetit, përfshirë efektet e ndryshimeve në supozimet e përdorura në teknikat e vlerësimit të entitetit, që synojnë t'i japin përdoruesve njohuri mbi pasigurinë e matjes së një shume të regjistruar ose të paraqitur.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Vogla

A136. Informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të entiteteve më të vogla mund të jenë më pak të hollësishme ose më pak të ndërlikuara (p.sh. disa kuadro të raportimit financiar lejojnë entitetet më të vogla të japin më pak të dhëna në pasqyrat financiare). Sidoqoftë, kjo nuk e lehtëson audituesin nga përgjegjësia për të njohur entitetin dhe mjedisin të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm.

Kontrollet e Lidhura me Pohimet (Ref:Para.26(c))

A137. Për të bërë vlerësimin e rrezikut, audituesi mund të evidentojë kontrollet që ka të ngjarë të ndalojnë, zbulojnë dhe të korrigjojnë anomalinë materiale në pohimet specifike. Përgjithësisht, audituesi arrin të kuptojë kontrollet dhe i lidh ato me pohimet në kontekstin e proceseve dhe të sistemeve në të cilat ato ekzistojnë sepse aktivitetet individuale të kontrollit, shpesh nuk trajtojnë një rrezik. Shpesh për të trajtuar rrezikun, do të mjaftonin vetëm aktivitetet e kontrollit të shumëfishta, së bashku me elementet e tjera të kontrollit të brendshëm.

A138. Nga ana tjetër, disa aktivitete kontrolli mund të kenë një efekt të veçantë në një pohim të specifik që trupëzohet në një klasë të veçantë të transaksioneve ose të një teprice në llogari. Për shembull, aktivitetet e kontrollit, që vendos një entitet për të siguruar që personeli i tij bën numërimin dhe regjistron në mënyrën e duhur elementet gjatë inventarizimit fizik vjetor, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me pohimet e ekzistencës dhe të plotësisë së gjendjeve kontabël të elementeve të këtyre inventarëve.

A139. Kontrollet mund të jenë të lidhura direkt ose indirekt me një pohim të caktuar. Sa më indirekte të jetë lidhja, aq më pak efektiv është kontrolli për të ndaluar, zbuluar dhe korrigjuar anomalitë në atë pohim. Për shembull, rishikimi që një drejtues i shitjeve i bën një raportimi përmbledhës të aktivitetit të shitjeve për dyqanet e veçanta sipas rajoneve, zakonisht lidhet indirekt me pohimin për plotësinë e të ardhurave nga shitjet. Rrjedhimisht, kjo procedurë mund të jetë më pak efektive për të ulur rrezikun krahasuar me kontrollet që lidhen më direkt me këtë pohim,

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

siç janë krahasimi i dokumenteve të transportit me dokumentet e faturimit.

Anomalitë materiale

A139. Anomalitë e mundshme në pasqyrat individuale dhe shënimet shpjeguese mund të gjykojnë të jenë materiale për shkak të madhësisë, natyrës ose rrethanave. (Ref. Para.26(d))

Rreziqet e Rëndësishme

Identifikimi i Rreziqeve të Rëndësishme (Ref: Para.28)

A140. Rreziqet e rëndësishme shpesh lidhen me transaksionet e rëndësishme jo-rutinë (jo të përditëshme) dhe me çështjet e gjykimit. Transaksionet jo-rutinë janë transaksionet e pazakonta për shkak ose të përmasave ose të natyrës dhe që për këtë arsye nuk ndodhin shpesh. Çështjet e gjykimit mund të përfshijnë bërjen e çmuarjeve kontabël, për të cilat ka pasiguri të konsiderueshme lidhur me vlerësimin. Transaksionet jo-komplekse dhe rutinë, të cilat janë subjekt i përpunimit sistematik, ka më pak të ngjarë që të shkaktojnë rreziqe të rëndësishme.

A141. Rreziqet e anomalive materiale, mund të jenë më të mëdha për rreziqet që lidhen me transaksionet e rëndësishme jo-rutinë, që lindin nga çështje të tilla si:

- Ndërhyrjet e mëdha të drejtuesve për të specifikuar trajtimet kontabël.
- Ndërhyrjet e mëdha gjatë procesit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave.
- Kompleksiteti i llogaritjeve dhe i parimeve kontabël.
- Natyra e transaksioneve jo-rutinë, të cilat e bëjnë të vështirë për entitetin që të zbatojë kontrolle efektive mbi rreziqet.

A142. Rreziqet e anomalisë materiale mund të jenë më të mëdha për rreziqe që lidhen me çështje të rëndësishme të gjykimit, që kërkojnë bërjen e çmuarjeve kontabël, të cilat burojnë nga:

- Parimet kontabël lidhur me çmuarjet kontabël, apo me njohjen e të ardhurave, të cilat mund të jenë subjekt i interpretimeve të ndryshme.
- Gjykimi i kërkuar mund të jetë subjektiv, kompleks ose të kërkojë supozime mbi efektet e ngjarjeve të ardhëshme, për shembull gjykimet mbi vlerën e drejtë

A143. SNA 330 përshkruan konsekuencat për procedura auditimi të mëtejshme që përdoren për të vlerësuar një rrezik si të rëndësishëm.²⁰

Rreziqet e Rëndësishme që lidhen me Rreziqet e Anomalisë Materiale si Pasojë e Mashtrimit

A144. SNA 240 paraqet kërkesa dhe udhëzime të mëtejshme në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale si pasojë e mashtrimit.²¹

Njohja e Kontrolleve që kanë të Bëjnë me Rreziqet e Rëndësishme (Ref:Para. 29)

A145. Meqënëse rreziqet që lidhen me aspektet e rëndësishme jo-rutinë ose me aspekte të gjykimit, shpesh ka pak mundësi që të jenë subjekt i kontrolleve rutinë, drejtuesit mund të përgjigjen në mënyra të ndryshme nëpërmjet të cilave synojnë të trajtojnë rreziqe të tilla. Prandaj, njohja nga audituesi e mënyrës sesi entiteti ka hartuar dhe zbatuar kontrollet për rreziqet e rëndësishme që burojnë nga aspektet jo-rutinë ose të gjykimit përfshin njohjen e mënyrës se si drejtuesit i përgjigjen rrezikut. Përgjigje të tilla mund të përfshijnë:

- Aktivitete kontrolli, të tilla si rishikimi i supozimeve të bëra nga drejtuesit kryesorë ose ekspertët.
- Procedura të dokumentuara për vlerësimet.
- Aprovim nga personat e ngarkuar me qeverisjen.

A146. Për shembull, nëse ndodh ndonjë ngjarje vetëm një herë, siç është marrja e një njoftimi për një proces gjyqësor të rëndësishëm, marrja në konsideratë e reagimit të entitetit do të përfshijë aspekte të tilla si, fakti nëse referimi ju është bërë ekspertëve të duhur (siç janë konsulentët ligjorë të brendshëm ose të jashtëm), nëse është realizuar ndonjë vlerësim i efekteve potenciale dhe mënyra e propozuar për t'i përfshirë këto kushte në informacionet e dhëna në pasqyrat financiare.

A147. Në disa raste, drejtuesit mund të mos jenë përgjigjur në mënyrën e duhur ndaj rreziqeve të rëndësishme të anomalisë materiale nëpërmjet zbatimit të kontrolleve ndaj tyre. Dështimi i drejtimit në zbatimin e kontrolleve të tillë është një tregues i një mangësie të rëndësishme në kontrollin e brendshëm.²²

Rreziqet për të Cilat Kryerja Vetëm e Procedurave Thelbësore nuk Jep Evidencën e

²⁰ SNA330, paragrafët 15 dhe 21.

²¹ SNA240, paragrafët 26–28.

²² SNA265, *Komunikimi i Mangësive në Kontrollin e Brendshëm Personave të Ngarkuar me Qeverisjen dhe Drejtimin*, paragrafi A7.

Nevojshme të Auditimit (Ref: Para.30)

- A148. Rreziqet e anomalisë materiale mund të kenë të bëjnë direkt me regjistrimin e klasave të zakonshme të transaksioneve ose të tepricave të llogarive dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të besueshme. Rreziqe të tillë mund të përfshijnë rreziqet e përpunimeve të pasakta ose jo të plota të transaksioneve, siç janë të ardhurat e entitetit, blerjet, dhe arkëtimet apo pagesat me para në dorë.
- A149. Në rastet kur transaksionet e biznesit me natyrë rutinë realizohen nga procese mjaft të automatizuara me pak apo aspak ndërhyrje manuale, mund të mos jetë e mundur që të kryhen vetëm procedurat thelbësore në lidhje me rreziqet. Për shembull, audituesi mund të konsiderojë që kemi të bëjmë me një rast të tillë në kushtet kur një shumë e konsiderueshme e informacionit të entitetit ka filluar, është regjistruar, përpunuar, ose raportuar në mënyrë elektronike, siç është për shembull një sistem i integruar. Në të tilla raste:
- Evidenca e auditimit mund të jetë e disponueshme vetëm në formë elektronike dhe mjaftueshmëria e përshtatshmëria e saj, zakonisht varen nga efektiviteti i kontrollit mbi saktësinë dhe plotësinë e saj.
 - Mundësia që të ndodhin regjistrime dhe modifikime të informacionit dhe të mos zbulohen është më e madhe nëse kontrollet e duhura nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive.
- A150. Konsekuencat për procedura auditimi të mëtejshme që përdoren për të identifikuar rreziqe të tilla përshkruhen tek SNA 330.²³

Rishikimi i Vlerësimit të Rrezikut(Ref: Para.31)

- A151. Gjatë auditimit mund të ndodhë që audituesi të sigurojë një informacion i cili ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga informacioni mbi të cilin është bazuar vlerësimi i rrezikut. Për shembull, vlerësimi i rrezikut mund të bazohet në supozimin që disa nga kontrollet funksionojnë në mënyrë efektive. Gjatë kryerjes së testeve të këtyre kontrolleve, audituesi mund të sigurojë evidencë auditimi që tregon se kontrollet nuk kanë funksionuar me efektivitetin e duhur gjatë kohës kur është kryer auditimi. Në të njëjtën mënyrë, gjatë realizimit të procedurave thelbësore, audituesi mund të zbulojë anomali në shuma apo në frekuencë, të cilat janë më të mëdha nga niveli i përcaktuar në vlerësimet që audituesi i ka bërë rrezikut. Në rrethana të tilla, vlerësimi i rrezikut mund të mos reflektojë në mënyrën e duhur rrethanat e vërteta të entitetit dhe procedurat e mëtejshme të auditimit mund të mos jenë efektive në zbulimin e anomalive materiale. Referoju SNA 330 për udhëzime të mëtejshme.

²³ SNA330,paragrafi8.

Dokumentimi (Ref: Para. 32)

- A152. Mënyra e dokumentimit të çështjeve të paraqitura në pragrafin 32 i shërben audituesit për të përcaktuar përdorimin e gjykimit profesional. Për shembull në auditimet e entiteteve të vogla dokumentimi i këtyre çështjeve mund t'i bashkangjitet dokumentimit të strategjisë së përgjithshme dhe planit të auditimit²⁴. Në mënyrë të ngjashme, për shembull, rezultatet e vlerësimit të rrezikut mund të dokumentohen veças, ose mund të dokumentohen si pjesë e dokumentimit që audituesi ju bën procedurave të mëtejshme²⁵ të auditimit. Forma dhe shtrirja e dokumentimit ndikohet nga natyra, madhësia dhe kompleksiteti i entitetit dhe i kontrollit të tij të brendshëm, disponibilitetit të informacionit nga entiteti si edhe metodologjia dhe teknologjia e auditimit të përdorur gjatë periudhës së auditimit.
- A153. Për entitetet të cilat kanë veprimtari dhe procese jo të komplikuar përse i përket raportimit financiar, dokumentimi mund të jetë i thjeshtë në formë dhe relativisht i shkurtër. Gjithashtu nuk është e nevojshme që të dokumentohet e gjithë njohja që audituesi ka për entitetin dhe çështjet e lidhura me të. Në elementët kryesorë të njohjes të dokumentuar nga audituesi përfshihen ato elementë mbi bazën e të cilëve audituesi ka mbështetur vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale.
- A154. Shtrirja e dokumentimit reflekton gjithashtu eksperiencën dhe aftësitë e anëtarëve të grupit të angazhimit të auditimit. Me kushtin që kërkesat e SNA 230 të plotësohen gjithmonë, një auditim i kryer nga një grup angazhimi ku janë përfshirë edhe individë me më pak eksperiencë kërkon një dokumentim më të detajuar, sesa në rastin kur janë përfshirë individë me eksperiencë, me qëllimin për t'i ndihmuar ata që të kenë një njohje të përshtatshme të entitetit.
- A155. Në rastin e auditimeve të vazhdueshme, një pjesë e dokumentacionit mund të përdoret edhe në auditimin e ardhshëm, duke u rifreskuar sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet në veprimtaritë dhe proceset e entitetit.

²⁴ SNA300, *Planifikimi i një Auditimi të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 7 dhe 9.

²⁵ SNA330, paragrafi 28.

Shtojca 1

(Ref:4(c), 14–24,A77-A121)

Elementët Përbërës të Kontrollit të Brendshëm

1. Kjo shtojcë shpjegon më tej elementët përbërës të kontrollit të brendshëm, siç janë përcaktuar në paragrafët 4(c),14–24dhe A77–A121, duke qënë se janë të lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

Mjedisi i Kontrollit

2. Mjedisi i kontrolli përfshin elementët e mëposhtëm:
 - (a) *Komunikimi dhe detyrimi për zbatimin e vlerave etike dhe të integritetit.* Efektiviteti i kontroleve nuk mund të ngrihet mbi vlerat etike dhe të integritetit të njerëzve të cilët i krijojnë administrojnë, dhe i vëzhgojnë ato. Integriteti dhe sjellja etike janë produkt i standardeve të sjelljes dhe të etikës së entitetit, i mënyrës së komunikimit dhe zbatimit të tyre në praktikë. Detyrimi për zbatimin e vlerave etike dhe integritetit përfshin për shembull, veprimet e drejtimit për të eliminuar apo për të kufizuar motivimin dhe tendencat që mund ta shtyjnë personelin të përfshihet në veprime jo të ndershme, jo ligjore ose akte joetike. Komunikimi i politikave të entitetit mbi integritetin dhe vlerat etike mund të përfshijë komunikimin e standardeve të sjelljes të personelit nëpërmjet deklarimit të politikave dhe kodeve të sjelljes dhe nëpërmjet shembujve.
 - (b) *Angazhimi për të mbajtur kompetencën profesionale.* Kompetenca përfshin njohuritë dhe zotësitë e nevojshme që duhen për të realizuar detyrat që janë të përcaktuara në punën e individit.
 - (c) *Pjesëmarrja e personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit.* Ndërgjegjja e kontrollit në një entitet ndikohet në mënyrë të ndjeshme nga personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e entitetit. Rëndësia e përgjegjësive të personave të ngarkuar me qeverisjen është sanksionuar nëpërmjet kodeve të praktikës dhe në ligje dhe rregulla të tjera apo në udhëzuesit e hartuar në shërbim të personave të ngarkuar me qeverisjen. Personat e ngarkuar me qeverisjen kanë edhe përgjegjësi të tjera ku përfshihet mbikëqyrja e hartimit dhe funksionimit efektiv të procedurave parandaluese dhe procesit që përdoret për rishikimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm të entitetit.
 - (d) *Filozofia e drejtimit dhe stili i operimit.* Filozofia e drejtimit dhe stili i operimit përfshin një gamë të gjerë karakteristikash. Për shembull, qëndrimet e drejtimit dhe veprimet e tij ndaj raportimit financiar mund të dalin në pah nëpërmjet përzgjedhjes agresive apo konservative midis parimeve alternative

të vlefshme të kontabilitetit, apo ndërgjegjshmërisë dhe konservatorizimit me anë të cilave janë bërë çmuarjet kontabël.

- (e) *Struktura organizative.* Vendorsja e një strukture të përshtatshme organizative përfshin marrjen në konsideratë të aspekteve kryesore të autoritetit dhe të përgjegjësisë, si dhe të linjave të duhura të raportimit. Përshtatshmëria e një strukture organizative në një entitet varet pjesërisht, nga madhësia dhe natyra e aktiviteteve të tij.
- (f) *Përcaktimi i autoritetit dhe i përgjegjësisë.* Përcaktimi i autoritetit dhe përgjegjësisë përfshin politikat që lidhen me praktikën e duhura të biznesit, njohuritë dhe eksperiencat e personave kyç dhe burimet e siguruara për realizimin e këtyre detyrave. Veç kësaj, këtu përfshihen politikat dhe komunikimi i drejtpërdrejtë për të siguruar që i gjithë personeli i kupton objektivat e entitetit, për të kuptuar mënyrën e ndërlidhjes së veprimeve të tyre individuale dhe kontributin në arritjen e objektivave, si dhe për të ditur se për çfarë dhe në çfarë mënyre ata do të mbajnë përgjegjësi.
- (g) *Politikat dhe praktikën e burimeve njerëzore.* Politikat dhe praktikën e burimeve njerëzore shpesh reflektojnë çështje të rëndësishme në lidhje me ndërgjegjen e kontrollit në një entitet. Për shembull, standardet për rekrutimin e personave më të kualifikuar me theksin në përgatitjen arsimore, eksperiencën e mëparshme në punë, arritjet e mëparshme dhe evidencën për integritet dhe sjelljen etike tregojnë obligimin e entitetit për punonjës kompetentë dhe të besueshëm. Politikat e kualifikimit, të cilat transmetojnë rolin dhe përgjegjësitë për të ardhmen dhe përfshijnë praktikën të tilla si shkollat e kualifikimit dhe seminarët, shprehin nivelet e pritshme të sjelljes dhe të performancës. Promovimi që rrjedh nga vlerësimi periodik i performancës, tregon përfshirjen e entitetit në përparimin e personelit të kualifikuar, në nivelet më të larta të përgjegjësisë.

Procesi i Vlerësimit të Rrezikut të Entitetit

3. Për qëllimet e raportimit financiar, procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit përfshin mënyrën se si drejtimi identifikon rreziqet e biznesit që lidhen me përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar të entitetit, çmon rëndësinë e tyre, vlerëson mundësinë e ndodhjes së tyre dhe vendos për veprimet që duhet të ndërmerren në përgjigje ndaj tyre dhe për për menaxhimin e tyre dhe të rezultateve që rrjedhin nga to. Për shembull, procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit mund të referohet mënyrës se si entiteti merr në konsideratë mundësinë e ekzistencës së transaksioneve të paregjistruara ose identifikon dhe analizon parashikimet e rëndësishme të evidentuara në pasqyrat financiare.

4. Rreziqet e lidhura me raportimin financiar të besueshëm përfshijnë ngjarjet e brendshme dhe të jashtme, transaksionet dhe rrethanat që mund të ndodhin dhe që ndikojnë negativisht në aftësinë e entitetit për të filluar, regjistruar, përpunuar dhe raportuar të dhënat financiare në koherencë me pohimet e drejtimit në pasqyrat financiare. Drejtimi mund të fillojë plane, programe ose veprime për të trajtuar rreziqet specifike ose ai mund të vendosë të pranojë një rrezik për shkak të kostos ose të vlerësimeve të tjera. Rreziqet mund të lindin ose ndryshohen për shkak të rrethanave të mëposhtme:

- *Ndryshimet në mjedisin e funksionimit.* Ndryshimet në mjedisin regullator apo atë funksionues mund të rezultojnë në ndryshime në presionin konkurrues dhe në rreziqe të ndryshëm të rëndësishëm.
- *Personel i ri.* Punonjësit e rinj mund të kenë një konceptim të ndryshëm mbi kontrollin e brendshëm.
- *Sistemet e informacionit të reja ose të rinovuara.* Ndryshmet e rëndësishme dhe të shpejta në sistemet e informacionit mund të ndryshojnë rrezikun që lidhet me kontrollin e brendshëm.
- *Rritja e shpejtë.* Zgjerimi i shpejtë dhe i konsiderueshëm i operacioneve mund ta dëmtojë kontrollin dhe të rrisin rrezikun e një mosfunksionimi të kontrolleve.
- *Teknologjitë e reja.* Përfshirja e teknologjive të reja në proceset e prodhimit apo në sistemet e informacionit mund të ndryshojë rreziqet që lidhen me kontrollin e brendshëm.
- *Modelet e reja të bizneseve, produkteve apo aktiviteteve.* Hyrja në fusha apo transaksione të biznesit në të cilat një entitet ka pak eksperiencë mund të shkaktojë rreziqe të reja që lidhen me kontrollin e brendshëm.
- *Ristrukturimi i korporatës.* Ristrukturimi mund të shoqërohet me shkurtimin e numrit të punonjësve dhe ndryshime në mbikqyrjen dhe ndarjen e detyrave, fakt që mund të sjellë ndryshime në rreziqet që lidhen me kontrollin e brendshëm.
- *Zgjerimi i veprimeve të jashtëm.* Zgjerimi apo blerja e entiteteve të huaja mbart shpesh rreziqe të reja dhe unike që mund të ndikojnë në kontrollin e brendshëm, për shembull, rreziqet shtesë apo të ndryshuara që vijnë nga transaksionet në monedhë të huaj.
- *Deklarime të reja kontabël.* Adoptimi i parimeve të reja kontabël apo ndryshimi i parimeve kontabël mund të ketë ndikim në rreziqet në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Sistemi i Informacionit, Përfshirë Proceset Përkatëse të Biznesit që Kanë të Bëjnë me Raportimin Financiar dhe Komunikimi

5. Një sistem informacioni konsiston në infrastrukturën (fizike dhe komponentët e hardëare), programet kompjuterike, njerëzit, procedurat, dhe të dhënat. Shumica e sistemeve të informacionit përdorin gjerësisht teknologjinë e informacionit (TI).
6. Sistemi i informacionit që lidhet me objektivat e raportimit financiar, i cili përfshin sistemin e raportimit financiar, përmbledh metodat dhe regjistrimet që:
 - Identifikojnë dhe regjistrojnë të gjitha transaksionet e miratuara.
 - Përshkruajnë transaksionet në mënyrë kronologjike dhe me detaje të mjaftueshme për të realizuar klasifikimin e tyre të përshtatshëm për nevojat e raportimit financiar.
 - Matin vlerën e transaksioneve në një mënyrë që lejon regjistrimin e vlerës së tyre monetare në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare.
 - Përcaktojnë peridhën kohore në të cilën kanë ndodhur transaksionet në atë mënyrë që lejon regjistrimin e tyre në periudhën e duhur kontabël.
 - Pasqyrojnë në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare transaksionet dhe informacionet e tjera.
7. Cilësia e informacionit të gjeneruar nga sistemi ndikon në aftësinë e drejtimit për të marrë vendimet e duhura lidhur me drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të entitetit dhe për të përgatitur raporte financiare të besueshme.
8. Komunikimi i cili përfshin sigurimin e njohjes së roleve dhe të përgjegjësive që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm mbi pasqyrat financiare, mund të marrë forma të tilla si manualët e politikave, manualët e raportimit kontabël dhe financiar dhe memorandumet. Gjithashtu komunikimi mund të realizohet në formë elektronike, verbale dhe përmes veprimeve të drejtimit.

Aktivitetet e Kontrollit

9. Përgjithësisht, aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin:
 - *Rishikimeve të performancës.* Këto aktivitete kontrolli përfshijnë rishikimin dhe analizën e performancës aktuale kundrejt buxheteve, parashikimeve dhe performancës së periudhave të mëparshme; duke krahasuar grupe të ndryshme të të dhënave- operative apo financiare - me njëra tjetrën, së bashku me analizën e relacioneve dhe kryerjen e veprimeve investiguese e korrigjuese; duke krahasuar

të dhënat e brendshme me burimet e jashtëme të informacionit; dhe rishikimin e performancës funksionale apo të aktivitetit.

- *Përpunimit të informacionit.* Dy grupimet e gjëra të sistemeve të informacionit për aktivitetet e kontrollit janë kontrolli i programeve, i cili zbatohet në përpunimin e programeve individuale dhe kontrollet e përgjithshme të sistemeve TI, të cilët janë politika dhe procedura që lidhen me shumë programe, si dhe mbështesin funksionimin në mënyrë efektive të kontrolleve të programeve duke ndihmuar që të sigurohet funksionimi në vazhdimësi dhe si duhet i sistemeve të informacionit. Shembuj të kontrolleve të programeve përfshijnë kontrollin mbi saktësinë matematikore të regjistrimeve, duke mbajtur dhe rishikuar llogaritë dhe bilancin vërtetues, kontrollet e automatizuara të tilla si paraqitja e kontrolleve të hyrjes së të dhënave dhe kontrolli i rrjedhës kronologjike, dhe ndjekja në mënyrë manuale e raporteve përjashtuese. Shembuj të kontrolleve të përgjithshme të sistemeve TI janë kontrolli i ndryshimit të programeve, kontrolli që kufizon të drejtën e hyrjes në të dhënat ose mbi programet, kontrolli mbi zbatimin e elementeve të reja të programeve të paketave të softëare-ve, dhe kontrollin mbi sistemin e softëare-ve që kufizon të drejtën për të hyrë, vëzhguar ose përdorur paisjet e sistemit me anën e të cilave mund të ndryshohen të dhënat financiare ose regjistrimet pa lënë gjurmë auditimi.
- *Kontrollet fizike.* Kontrolle që përfshijnë:
 - Sigurimin fizik të aktiveve duke përfshirë masat e duhura mbrojtëse siç janë paisjet e sigurisë mbi të drejtën e hyrjes në aktivet dhe regjistrat.
 - Autorizimin për të drejtën e hyrjes në programet e kompjuterit dhe dosjet e të dhënave.
 - Numërimin periodik e krahasimin me shumat e treguara nga regjistrat e kontrollit (për shembull krahasimi i rezultateve të inventarizimit të gjendjes së parasë, letrave me vlerë dhe i inventarëve me shumat në regjistrimet kontabël).

Shkalla në të cilën, kontrollet fizike që synojnë të parandalojnë vjedhjet e aktiveve, lidhen me besueshmërinë e përgatitjes së pasqyrave financiare, dhe për pasojë, edhe me auditimin, varen nga rrethana të tilla siç është rasti kur aktivet janë shumë të prekëshme nga vjedhja.

- *Ndarja e detyrave.* Realizohet duke ju dhënë njerëzve të ndryshëm përgjegjësi për autorizimin e transaksioneve, regjistrimin e tyre dhe mbajtjen e sigurtë të aktiveve. Ndarja e detyrave synon të kufizojë oportunitetet që lejojnë cilindo punonjës të mund të realizojë si kryerjen ashtu edhe

korrigjimin e gabimeve apo mashtrimin gjatë kryerjes së zakonshme të detyrës.

10. Disa aktivitete kontrolli mund të varen nga ekzistenca e politikave të duhura në nivele të larta të vendosura nga drejtimi apo personat e ngarkuar me qeverisjen. Për shembull, kontrollet e autorizimit mund të delegohen në përputhje me udhëzimet e vendosura, siç janë kriteret e investimit të vendosura nga personat e ngarkuar me qeverisjen, ose ndryshe transaksionet jo-rutinë (të zakonshme) siç janë blerjet kryesore ose ndryshime që mund të kërkojnë aprovime të veçanta nga nivelet e larta, duke përfshirë në disa raste edhe atë të aksionerëve.

Vëzhgimi i Kontrolleve

11. Një përgjegjësi e rëndësishme e drejtimit është vendosja dhe mbajtja e kontrollit të brendshëm në mënyrë të vazhdueshme. Vëzhgimi i kontrolleve nga ana e drejtimit përfshin marrjen në konsideratë të faktit nëse ato funksionojnë sipas qëllimit si edhe nëse janë modifikuar në mënyrën e duhur, kur ka patur ndryshim të kushteve. Vëzhgimi i kontrolleve mund të përfshijë aktivitete të tilla si rishikimi nga drejtimi i faktit nëse rakordimi i llogarive bankare bëhet në kohën e duhur, vlerësimin e audituesit të brendshëm për veprimet e personelit të shitjes në përputhje me politikat e entitetit mbi kushtet e kontratave të shitjes dhe një mbikqyrje e departamentit juridik mbi pajtueshmërinë me etikën e entitetit ose politikat e praktikës së biznesit. Vëzhgimi realizohet gjithashtu për të siguruar që kontrollet vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë efektive përgjatë kohës. Për shembull, nëse nuk vëzhgohet kryerja në kohë dhe me saktësi e rakordimeve të llogarive bankare, atëherë personeli ka të ngjarë që të ndërpresë përgatitjen e tyre.
12. Audituesit e brendshëm ose personeli që realizojnë funksione të ngjashme, mund të kontribuojnë në vëzhgimin e kontrolleve të entitetit nëpërmjet vlerësimeve të veçanta. Zakonisht, ata në mënyrë të rregullt sigurojnë informacione mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke e fokusuar vëmendjen në mënyrë të konsiderueshme në vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm, dhe komunikojnë informacion mbi pikat e forta dhe mangësitë dhe rekomandojnë për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.
13. Aktivitetet e vëzhgimit mund të përfshijnë përdorimin e informacionit nga komunikimi me palët e jashtme që mund të tregojë për probleme apo të hedhë dritë mbi aspektet që kanë nevojë të përmirësohen. Konsumatorët në mënyrë indirekte konfirmojnë të dhënat e faturuara duke paguar faturat e tyre apo duke u ankuar për shumat vënë në ngarkim. Përveç kësaj, agjencitë rregullatore mund të komunikojnë me entitetet për problemet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm, për shembull, komunikimi në lidhje me ekzaminimin nga agjencitë rregullatore bankare. Gjithashtu, në kryerjen e vëzhgimit drejtimi mund të marrë në konsideratë komunikimin për kontrollin e brendshëm që bëhet nga audituesit e jashtëm.

Kushtet dhe Ngjarjet që Mund të Tregojnë për Rreziqe të Anomalisë Materiale

Më poshtë janë paraqitur shembuj të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë ekzistencën e rreziqeve të anomalisë materiale. Këta shembuj mbulojnë një gamë të gjerë të kushteve dhe të ngjarjeve; megjithatë, jo të gjitha kushtet dhe ngjarjet janë të përshtatshme për çdo angazhim auditimi dhe lista e shembujve nuk është domosdoshmërisht e plotë.

- Operacionet realizohen në rajone që janë ekonomikisht jo të qëndrueshme për shembull, vendet me zhvlerësim të ndjeshëm të monedhës apo ekonomitë me inflacion të lartë.
- Operacionet janë të ekspozuara ndaj tregjeve të paqëndrueshëm (apo të ndryshueshëm) për shembull, tregtimet e marrëveshjeve të ardhshme.
- Operacionet që janë subjekt i një shkalle të lartë dhe komplekse të rregullimit.
- Çështjet e vijimësisë dhe të likuiditetit, përfshirë humbjen e konsumatorëve të rëndësishëm.
- Kufizime në disponueshmërinë e kapitalit dhe të kreditit.
- Ndryshime në sektorin e industrisë ku vepron entiteti.
- Ndryshime në hallkat e furnizimeve.
- Zhvillimi apo ofrimi i produkteve apo shërbimeve të reja, apo zhvendosja drejt linjave të reja të biznesit.
- Zgjerimi në rajone të reja.
- Ndryshime në entitet të tilla si blerje të mëdha apo riorganizime ose ndonjë ngjarje tjetër e pazakontë.
- Entitetet apo segmentet e biznesit ka të ngjarë të shiten.
- Ekzistenca e aleancave komplekse apo sipërmarrjeve të përbashkëta (joint ventures).
- Përdorimi i financimeve jashtë-bilancit, entitetet për qëllime të veçanta, dhe marrëveshje të tjera komplekse të financimit.

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE TË ANOMALISË MATERIALE
NËPËRMJET NJOHJES SË ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ

- Transaksione të rëndësishme me palët e lidhura.
- Mangësi të personelit me aftësitë e duhura mbi raportimin kontabël dhe financiar.
- Ndryshimet në personelin kryesor, përfshirë largimin e drejtuesve ekzekutive kryesorë.
- Dobësitë në kontrollin e brendshëm, veçanërisht ato që nuk janë trajtuar nga drejtimi.
- Jokoherenca midis strategjisë së sistemit TI të entitetit dhe strategjisë së biznesit të tij.
- Ndryshime në mjedisin e sistemit TI.
- Instalimi i sistemeve të reja të rëndësishme të TI që lidhen me raportimin financiar.
- Investigimi i rezultateve operacionale apo financiare nga agjencitë rregullatore apo qeveritare.
- Anomalitë e së kaluarës, historiku i gabimeve, apo rregullimet në fund të periudhës në një masë të konsiderueshme.
- Një masë e konsiderueshme e transaksioneve jo-rutinë apo jo-sistematike, përfshirë transaksionet midis kompanive dhe transaksionet e të ardhurave në vlera të mëdha në fund të periudhës.
- Transaksionet e regjistruara bazuar në qëllimin e drejtimit për shembull, rifinancimi i borxhit, aktivet për shitje dhe klasifikimi i letrave me vlerë të tregtueshme.
- Zbatimi i deklarimeve të reja kontabël.
- Përlllogaritjet kontabël që përfshijnë procese komplekse.
- Ngjarjet apo transaksionet që bazohen në pasigurinë e treguesve të rëndësishëm, përfshirë çmuarjet kontabël.
- Heqja ose fshehja e informacioneve të rëndësishme në shënimet shpjeguese.
- Paditë gjyqësore të pagjydhura dhe detyrimet e kushtëzuara për shembull, garancitë e shitjeve, garancitë financiare dhe trajtimet e rregullimeve mjedisore.